

MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT
NDËRMJET KOMUNITETEVE EUROPIANE
E SHTETEVE TË TYRE ANËTARE
DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

MBRETËRIA E BELGJIKËS,
REPUBLIKA ÇEKE,
MBRETËRIA E DANIMARKËS,
REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISË,
REPUBLIKA E ESTONISË,
REPUBLIKA HELENE,
MBRETËRIA E SPANJËS,
REPUBLIKA E FRANCËS,
IRLANDA,
REPUBLIKA E ITALISË,
REPUBLIKA E QIPROS,
REPUBLIKA E LETONISË,
REPUBLIKA E LITUANISË,
DUKATI I MADH I LUKSEMBURGUT,
REPUBLIKA E HUNGARISË,
REPUBLIKA E MALTËS,
MBRETËRIA E HOLLANDËS,
REPUBLIKA E AUSTRISË,
REPUBLIKA E POLONISË,
REPUBLIKA E PORTUGALISË,
REPUBLIKA E SLLOVENISË,

REPUBLIKA SLOVAKA,
REPUBLIKA E FINLANDËS,
MBRETËRIA E SUEDISË,
MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT,

Palët kontraktuese të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe të Traktatit themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Atomike, si dhe të Traktatit të Bashkimit Europian, referuar më poshtë si “Shtete Anëtare”,

dhe

KOMUNITETI EUROPIAN, KOMUNITETI EUROPIAN I ENERGJISË ATOMIKE,

referuar më poshtë si “Komuniteti”,

nga njëra anë, dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË, referuar më poshtë si “Shqipëria”,

nga ana tjetër,

DUKE MARRË PARASYSH lidhjet e forta ndërmjet Palëve dhe vlerat që i bashkojnë, dëshirën e tyre për të forcuar këto lidhje dhe për të vendosur marrëdhënie të ngushta e të qëndrueshme, bazuar në reciprocitet dhe interesat e ndërsjellë, të cilat duhet t'i japin mundësinë Shqipërisë të forcojë dhe zgjerojë më tej marrëdhëniet – të vendosura më parë me Komunitetin nëpërmjet Marrëveshjes mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar e Ekonomik të vitit 1992 – me Komunitetin dhe Shtetet e tij Anëtare;

DUKE MARRË PARASYSH rëndësinë e kësaj Marrëveshjeje në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit me vendet e Europës juglindore, për vendosjen dhe konsolidimin e një rendi të qëndrueshëm europian bazuar në bashkëpunim, për të cilin Bashkimi European është një shtyllë kryesore, si dhe në kuadër të Paktit të Stabilitetit;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të kontribuar me të gjitha mënyrat për stabilizimin politik, ekonomik e institucional të Shqipërisë dhe rajonit, nëpërmjet zhvillimit të shoqërisë civile dhe demokratizimit, ndërtimit të institucioneve dhe reformës së administratës publike, integritit në tregtinë rajonale dhe rritjes së bashkëpunimit ekonomik, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit në një gamë të gjerë fushash, veçanërisht në drejtësi dhe çështjet e brendshme dhe në forcimin e sigurisë kombëtare dhe rajonale;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për rritjen e lirive politike e ekonomike që janë bazat themelore të kësaj marrëveshjeje, si dhe angazhimin e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare, si dhe parimet demokratike nëpërmjet një sistemi shumëpartiak me zgjedhje të lira e të ndershme;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të zbatuar plotësisht të gjitha parimet dhe dispozitat e Kushtetutës së OKB-së, të OSBE-së, veçanërisht ato të Aktit Final të Helsinkit, dokumentet përfundimtare të Konferencave të Madridit dhe Vjenës, Kartën e Parisit për një Europë të Re, dhe të Paktit të Stabilitetit për Europën juglindore, në mënyrë që të kontribuojnë në stabilitetin rajonal dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve ndaj parimeve të ekonomisë së tregut të lirë dhe gatishmërinë e Komunitetit për të kontribuar për reformat ekonomike në Shqipëri;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve ndaj tregtisë së lirë, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga OBT-ja;

DUKE MARRË PARASYSH dëshirën e Palëve për të zhvilluar më tej një dialog politik të rregullt për çështje dypalëshe dhe ndërkombëtare me interes të ndërsjellë, përfshirë aspektet rajonale, duke pasur parasysh Politikën e Jashmte dhe e Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit European;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të luftuar krimin e organizuar dhe për të forcuar bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit në bazë të deklaratës së nxjerrë nga Konferenca Europiane më 20 tetor 2001;

ME BINDJEN që Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit krijon një klimë të re për marrëdhëniet ekonomike ndërmjet tyre dhe, mbi të gjitha, për zhvillimin e tregtisë dhe investimeve, që janë faktorë kryesorë për modernizimin dhe ristrukturimin ekonomik;

DUKE RIKUJTUAR angazhimin e Shqipërisë për të përafuar legjislacionin në sektorët përkatës me atë të Komunitetit dhe për ta zbatuar atë me efektivitet;

DUKE MARRË PARASYSH gatishmërinë e Komunitetit për të dhënë një mbështetje vendimtare për zbatimin e reformave dhe për të përdorur për këtë qëllim të gjitha instrumentet e disponueshme të bashkëpunimit dhe asistencës teknike, financiare e ekonomike mbi një bazë gjithëpërfshirëse shumëvjeçare për këtë përpjekje;

DUKE KONFIRMUAR që dispozitat e kësaj Marrëveshjeje që përfshihen në fushën e veprimit të Pjesës III, Titulli IV të Traktatit themelues të Komunitetit European e angazhojnë Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën si Palë Kontraktuese të veçanta, dhe jo si pjesë të Komunitetit European, derisa Mbretëria e Bashkuar ose Irlanda (sipas rastit) të njoftojë Shqipërinë se është angazhuar si pjesë e Komunitetit European në përputhje me Protokollin mbi pozicionin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës, i aneksuar Traktatit të Bashkimit European dhe Traktatit themelues të Komunitetit European. E njëjta gjë zbatohet edhe për Danimarkën, në përputhje me Protokollin mbi pozicionin e Danimarkës i aneksuar këtyre Traktateve;

DUKE RIKUJTUAR Samitin e Zagrebit, që bëri thirrje për konsolidim të mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet vendeve të Procesit të Stabilizim-Asociimit dhe Bashkimit European, dhe për rritjen e bashkëpunimit rajonal;

DUKE RIKUJTUAR që Samiti i Selanikut e përforcoi Procesin e Stabilizim-Asociimit si një kuadër politikash të Bashkimit Europian në marrëdhëniet me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe nënvizoi perspektivën e integrimit të tyre në Bashkimin Europian në bazë të përparimit të reformave dhe meritave individuale;

DUKE RIKUJTUAR Memorandumin e Mirëkuptimit për Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë, nënshkruar në Bruksel më 27 qershor 2001, nëpërmjet të cilit Shqipëria, së bashku me vende të tjera të rajonit, u angazhua të negociojë një rrjet Marrëveshjesh dypalëshe për Tregtinë e Lirë, me qëllim rritjen e aftësisë së rajonit për të tërhequr investime dhe të perspektivës së integrimit të tij në ekonominë globale;

DUKE RIKUJTUAR gatishmërinë e Bashkimit Europian për ta integruar Shqipërinë sa më plotësisht të jetë e mundur në rrjedhën e përgjithshme politike dhe ekonomike të Europës, si dhe statusin e saj si kandidat i mundshëm për anëtarësimin në BE në bazë të Traktatit të Bashkimit Europian dhe plotësimin e kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Europian në qershor të vitit 1993, që janë kusht për zbatimin me sukses të kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht për sa i përket bashkëpunimit rajonal,

BIEN DAKORD SI VIJON:

NENI 1

1. Në këtë mënyrë është vendosur një Asociim ndërmjet Komunitetit dhe Shteteve të tij Anëtare, nga njëra anë, dhe Shqipërisë, nga ana tjetër.

2. Synimet e këtij Asociimi janë:
 - të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe shtetin e së drejtës;
 - dhënia e kontributit për stabilitetin politik, ekonomik e institucional në Shqipëri, si dhe për stabilizimin e rajonit;
 - të sigurojë një strukturë të përshtatshëm për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve;
 - të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, gjithashtu dhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Komunitetit;
 - të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi tregu funksionale, të nxisë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë;
 - të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat të trajtuara në këtë Marrëveshje.

TITULLI I

PARIME TË PËRGJITHSHME

NENI 2

Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Europë të Re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, ato të shtetit të së drejtës si edhe për parimet e ekonomisë së tregut, siç pasqyrohen në Dokumentin e Konferencës së Bonit të KSBE-së për Bashkëpunimin Ekonomik, formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të Palëve dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 3

Paqja dhe stabiliteti ndërkombëtar dhe rajonal si dhe zhvillimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë janë themelore për Proçesin e Stabilizimit dhe Asociimit referuar në konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Europian të datës 21 qershor 1999. Përfundimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet në kuadër të konkluzioneve të Këshillit të Bashkimit Europian të datës 29 prill 1997, dhe bazohet në meritat individuale të Shqipërisë.

NENI 4

Shqipëria angazhohet të vazhdojë dhe të nxisë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e tjera të rajonit, duke përfshirë një nivel të përshtatshëm konçesionesh të ndërsjella lidhur me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, veçanërisht të atyre që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore dhe të drogave të paligjshme. Ky angazhim përbën një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Palëve, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajona.

NENI 5

Palët pohojnë edhe njëherë rëndësinë që i japin luftës kundër terrorizmit dhe zbatimit të detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë.

NENI 6

Asociimi zbatohet në mënyrë progresive dhe realizohet plotësisht gjatë një periudhe tranzitore deri në dhjetë vjet maksimumi, e ndarë në dy faza të njëpasnjëshme.

Dy fazat nuk janë të aplikueshme nën Titullin IV të kësaj Marrëveshjeje (Lëvizja e Lirë e Mallrave), për të cilin në atë Titull të Marrëveshjes përcaktohet një kalendar specifik.

Qëllimi i kësaj ndarjeje në faza të njëpasnjëshme është që të bëhet një rishikim i hollësishëm afatmesëm i zbatimit të Marrëveshjes. Në fushën e përafrimit dhe zbatimit të ligjeve, synimi është që Shqipëria të përqendrohet gjatë fazës së parë në elementët themelorë të *acquis*, me tregues specifikë, ashtu siç përshkruhet në Titullin VI të kësaj Marrëveshjeje.

Këshilli i Stabilizim-Asociimit i krijuar sipas nenit 116 do të shqyrtojë rregullisht zbatimin e Marrëveshjes dhe realizimin e reformave ligjore, administrative, institucionale dhe ekonomike nga ana e Shqipërisë, duke marrë parasysh çfarë është thënë më sipër dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të parashtruara në këtë Marrëveshje.

Faza e parë fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Gjatë vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të vlerësojë përparimin e bërë nga Shqipëria, dhe do të vendosë nëse ky përparim ka qenë i mjaftueshëm për kalimin në fazën e dytë në mënyrë që të arrijë asociimin e plotë. Ai do të vendosë gjithashtu edhe për dispozita të veçanta që konsiderohen të nevojshme për t'u zbatuar në fazën e dytë.

NENI 7

Marrëveshja duhet të përputhet plotësisht dhe zbatohet në përputhje me dispozitat përkatëse të OBT-së, në veçanti Nenin XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë për Shërbime (GATS) 1994 dhe Nenin V të GATS.

TITLE II

DIALOGU POLITIK

NENI 8

1. Dialogu politik ndërmjet Palëve zhvillohet më tej brenda kontekstit të kësaj Marrëveshjeje. Ai do të shoqërojë dhe konsolidojë marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit European dhe Shqipërisë dhe kontribuojë në vendosjen e lidhjeve të ngushta të solidaritetit dhe formave të reja të bashkëpunimit ndërmjet Palëve.
2. Dialogu politik ka për qëllim të nxisë veçanërisht:
 - integrimin e plotë të Shqipërisë në bashkësinë e kombeve demokratike dhe afrimin gradual me Bashkimin European;
 - një përputhje në rritje e pozicionimeve të Palëve për çështjet ndërkombëtare, gjithashtu nëpërmjet shkëmbimit të duhur të informacionit, dhe në veçanti, lidhur me ato çështje që pritet të kenë efekte të ndjeshme mbi Palët;
 - bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë;
 - pikëpamje të përbashkëta për sigurinë dhe stabilitetin në Europë, duke përfshirë dhe bashkëpunimin në fushat që mbulohen nga Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët e Bashkimit European.

3. Palët vlersojnë që armëve të shkatërrimit në masë (ASHM) dhe i mjeteve për shpërndarjen e tyre, në drejtim të aktorëve shtetërore dhe joshitetërorë, përfaqëson një nga kërcënimet më serioze për stabilitetin dhe sigurinë ndërkombëtare. Për këtë arsye palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe kontribuojnë kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe të mjeteve për shpërndarjen e tyre, nëpërmjet respektimit të plotë dhe zbatimit në nivel kombëtar të detyrimeve të tyre ekzistuese, detyrime këto që rrjedhin nga traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare për çarmatimin dhe mospërhapjen, si dhe detyrime të tjera ndërkombëtare. Palët bien dakord, që kjo dispozitë përbën një element thelbësor të kësaj Marrëveshjeje dhe do të jetë pjesë e dialogut politik që shoqëron dhe konsolidon këta elementë.

Palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe kontribuojnë kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe mjeteve të shpërndarjes së tyre:

- duke ndërmarrë hapa për të nënshkruar, ratifikuar, miratuar dhe zbatuar plotësisht të gjithë instrumentet e tjera përkatëse ndërkombëtare;
- duke vendosur një sistemi efikas kontrolli të eksportit kombëtar, që kontrollon eksportin ashtu edhe tranzitin e mallrave që lidhen me armët e shkatërrimit në masë (ASHM), përfshi kontrollin e qëllimit përfundimtar të ASHM-ve prodhuar nga teknologji me qëllime përdorimi të dyfishta; dhe që përmban sanksione efikase për mosrespektimin e kontrollit të eksporteve.

Dialogu politik mbi këtë çështje mund të zhvillohet në nivel rajonal.

NENI 9

1. Dialogu politik zhvillohet në Këshillin e Stabilizim-Asociimit, i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme për çdo çështje që Palët mund të dëshirojnë ta shtrojnë përpara tij.

2. Me kërkesë të Palëve, dialogu politik mund të zhvillohet edhe në formatet e mëposhtme:
- takime, kur është e nevojshme, të zyrtarëve të lartë që përfaqësojnë Shqipërinë, nga njëra anë, dhe Presidenca e Këshillit të Bashkimit European dhe Komisionit, nga ana tjetër;
 - shfrytëzimi i plotë i të gjithë kanaleve diplomatike ndërmjet Palëve, përfshirë kontaktet e përshtashtme në vendet e treta dhe brenda Kombeve të Bashkuara, OSBE-së, Këshillit të Europës dhe forumeve të tjera ndërkombëtare;
 - çdo mjet tjetër që do të jepte një kontribut të vlefshëm për konsolidimin, zhvillimin dhe thellimin e këtij dialogu.

NENI 10

Dialogu politik në nivel parlamentar zhvillohet brenda kuadrit të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit ngritur në bazë të nenit 122.

NENI 11

Dialogu politik mund të zhvillohet brenda një kuadri shumëpalësh, dhe si dialog rajonal duke përfshirë vende të tjera të rajonit.

TITULLI III

BASHKËPUNIMI RAJONAL

NENI 12

Në përputhje me angazhimet e saj për paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar e rajonal, si dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, Shqipëria duhet të promovojë bashkëpunimin rajonal në mënyrë aktive. Programet e asistencës të Komunitetit European mund të mbështesin projekte që përmbajnë dimension rajonal ose ndërkufitar, nëpërmjet programeve të tij për asistencë teknike.

Në rastet kur Shqipëria parashikon të përforcojë bashkëpunimin e saj me njërin nga vendet e përmendura në nenet 13 deri në 15 si më poshtë, ajo do të informojë dhe do të konsultohet me Komunitetin dhe Shtetet Anëtare të tij, në përputhje me dispozitat e Titullit X, Dispozitat Institucionale, të Përgjithshme dhe Përfundimtare.

Shqipëria rishikon Marrëveshjet dypalëshe ekzistuese me të gjitha vendet përkatëse, ose përfundon marrëveshje të reja, në mënyrë që të sigurojë përputhjen e tyre me parimet e Memorandumit të Mirëkuptimit mbi Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë nënshkruar në Bruksel më 27 qershor 2001.

NENI 13

Bashkëpunimi me vende tjera
që kanë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociim

Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do të nisë negociatat me vendet që tashmë kanë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi me qëllim nënshkrimin e konventave e konventave dypalëshe mbi bashkëpunimin rajonal, synimi i të cilave është rritja e fushave të bashkëpunimit ndërmjet vendeve në fjalë.

Elementet kryesorë të këtyre konventave jenë:

- dialogu politik;
- vendosja e një zone të tregtisë së lirë ndërmjet Palëve, në përputhje me dispozitat përkatëse të OBT-së;
- konçesione të ndërsjella lidhur me lëvizjen e punonjësve, vendosjen, ofrimin e shërbimeve, pagesat rrjedhëse dhe lëvizjen e kapitalit, si dhe politika të tjera që kanë të bëjnë me lëvizjen e personave në një nivel të barabartë me atë të kësaj Marrëveshjeje;
- dispozitat për bashkëpunimin në fusha të tjera të cilat trajtohen ose jo nga kjo Marrëveshje, dhe veçanërisht në fushën e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme.

Këto konventa do të përmbajnë dispozita për krijimin e mekanizmave të duhur institucionalë.

Shqipëria i nënshkruan këto konventa brenda dy vitesh pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Gatishmëria e Shqipërisë për të nënshkruar konventa të tilla është kusht për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian.

Shqipëria do të nisë negociata të ngjashme me vendet e tjera të rajonit, pasi këto vende të kenë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi.

NENI 14

Bashkëpunimi me vendet e tjera që marrin pjesë në procesin e stabilizim-asociimit

Shqipëria ndjek bashkëpunimin rajonal me vendet e tjera, që marrin pjesë në Procesin e Stabilizim-Asociimit, në disa ose të gjitha fushat e bashkëpunimit që mbulon kjo Marrëveshje, dhe veçanërisht në fushat me interes të përbashkët. Një bashkëpunim i tillë duhet të jetë gjithmonë në përputhje me parimet dhe objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

NENI 15

Bashkëpunimi me vendet candidate për aderim në BE

1. Shqipëria mund të nxisë bashkëpunimin dhe të përfundojë një konventë për bashkëpunimin rajonal me cilindo vend kandidat për aderim në BE, në cilëndo nga fushat e bashkëpunimit që mbulon kjo Marrëveshje. Një konventë e tillë ka për synim futjen graduale të marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe këtij vendi drejt një linje të përbashkët me marrëdhëniet që ka ai vend në këtë fushë me Komunitetin European dhe Shtetet Anëtare.
2. Shqipëria do të fillojë negociatat me Turqinë me synimin për të përfunduar, bazuar në avantazhe reciproke, një marrëveshje që vendos një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet të dy palëve në përputhje me Nenin XXIV të GATT (Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë), si dhe për të liberalizuar vendosjen dhe ofrimin e shërbimeve ndërmjet tyre në një nivel të barabartë me këtë marrëveshje në përputhje me Nenin V të GATS.

Këto negociata duhet të fillojnë sa më shpejt të jetë e mundur, me synimin për të përfunduar marrëveshjen e sipërpërmendur përpara fundit të periudhës tranzitore të përmendur në nenin 16(1).

TITULLI IV

LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

NENI 16

1. Komuniteti dhe Shqipëria do të vendosin gradualisht një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe maksimumi dhjetëvjeçare duke nisur nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me dispozitat e GATT 1994 dhe të OBT. Duke bërë këtë, ato marrin parasysh kërkesat specifike të parashtruara më poshtë.
2. Nomenklatura e Kombinuar e mallrave do të zbatohet për klasifikimin e mallrave në tregtinë ndërmjet të dyja Palëve.
3. Për çdo produkt, tarifa bazë mbi të cilin zbatohen reduktimet pasuese të vendosura në këtë Marrëveshje, është tarifa që faktikisht zbatohet erga omnes ditën para nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.
4. Tarifat e reduktuara që zbatohen nga Shqipëria, të llogaritura ashtu siç parashikohet në këtë Marrëveshje, rumbullakosen në numra të plotë duke përdorur parime aritmetike të zakonshme. Si rrjedhojë, të gjithë numrat që kanë 50 ose më pak pas presjes dhjetore, rumbullakosen në zbritje drejt numrit të plotë më të afërt, dhe të gjitha numrat që kanë më shumë se 50 pas presjes dhjetore, rumbullakosen në ngjitje të numrit të plotë më të afërt.

5. Nëse, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, zbatohet ndonjë reduktim tatimor mbi bazën *erga omnes*, në veçanti reduktimet që rrjedhin prej negociatave për tarifatat në OBT, tarifa të tilla të reduktuara zëvendësojnë tarifën bazë të përmendur në paragrafin 3, që nga data kur zbatohen reduktimet të tilla.

6. Komuniteti dhe Shqipëria do t'i komunikojnë njëri-tjetrit tarifatat bazë përkatëse të tyre.

—

KAPITULLI I

PRODUKTET INDUSTRIALE

NENI 17

1. Dispozitat e këtij Kapitulli janë të aplikueshme për produktet që e kanë origjinën në Komunitet ose Shqipëri, të renditura në Kapitujt 25 deri 97 të Nomenklaturës së Kombinuar, me përjashtim të produkteve të renditura në Shtojcën I. § I, (ii) të Marrëveshjes për bujqësinë (GATT 1994).

2. Tregtia ndërmjet Palëve të produkteve të përcaktuara nga Traktati themelues i Komunitetit European të Energjisë Atomike do të zhvillohet në përputhje me dispozitat e atij Traktati.

NENI 18

1. Detyrimet doganore për importet drejt Komunitetit të produkteve që e kanë origjinën në Shqipëri, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
2. Kufizimet sasiore për importet drejt Komunitetit, dhe masat me efekt të njëjtë me to për produktet që e kanë origjinën në Shqipëri, shfuqizohen në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 19

1. Detyrimet doganore për importet drejt Shqipërisë së mallrave që e kanë origjinën në Komunitet, përveç atyre të renditura në Shtojcën I, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
2. Detyrimet doganore për importet drejt Shqipërisë të mallrave që e kanë origjinën në Komunitet, të cilat janë renditur në Shtojcën I, reduktohen në mënyrë progresive në përputhje me kalendarin e mëposhtëm:
 - në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 80% të detyrimit bazë;
 - më 1 janar të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 60% të detyrimit bazë;

- në 1 janar të vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 40% të detyrimit bazë;
 - në 1 janar të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 20% të detyrimit bazë;
 - – në 1 janar të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 10% të detyrimit bazë;
 - – në 1 janar të vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimet e mbetura për importin shfuqizohen.
3. Kufizimet sasiore për importet drejt Shqipërisë së mallrave që e kanë origjinën në Komunitet dhe masat me efekt të barabartë me to, shfuqizohen në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 20

Komuniteti dhe Shqipëria, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, shfuqizojnë në tregtinë ndërmjet tyre çdo detyrim që ka efekt të barabartë me detyrimet doganore për importet.

NENI 21

1. Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti dhe Shqipëria shfuqizojnë tarifatat doganore për eksportet dhe tarifatat me efekt të njëjtë me to.
2. Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti dhe Shqipëria shfuqizojnë ndërmjet tyre të gjitha kufizimet sasiore për eksportet, dhe masat me efekt të njëjtë me to.

NENI 22

Shqipëria deklaron gatishmërinë e saj për të reduktuar tarifatat doganore në tregtinë me Komunitetin më shpejt se sa parashikohet në nenin 19, në rast se situata ekonomike e përgjithshme e saj dhe situata e sektorit ekonomik në fjalë e lejojnë këtë.

Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të analizojë situatën në këtë aspekt dhe do të japë rekomandimet e nevojshme.

NENI 23

Protokolli 1 parashtron rregullimet e zbatueshme për produktet e hekurit dhe çelikut të Kapitujve 72 dhe 73 të Nomenklaturës së Kombinuar.

KAPITULLI II

BUJQËSIA DHE PESHKIMI

NENI 24

Përkufizim

1. Dispozitat e këtij Kapitulli zbatohen për tregtinë e produkteve bujqësore dhe të peshkimit, që e kanë origjinën në Komunitet ose në Shqipëri.
2. Termi "produkte bujqësore dhe të peshkimit" u referohet produkteve të renditura në Kapitujt 1 deri 24 të Nomenklaturës së Kombinar, si dhe produkteve të renditura në Shtojcën I, §I, (ii) të Marrëveshjes për bujqësinë (GATT, 1994)
3. Ky përkufizim përfshin peshkun dhe produktet e peshkimit të mbuluara nga kapitulli 3, titujt 1604 dhe 1605, dhe nëntitujt 0511 91, 2301 20 00 dhe 1902 20 10

NENI 25

Protokolli 2 parashton rregullimet për tregtinë e produkteve bujqësore të përpunuara, që renditen aty.

NENI 26

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, Komuniteti shfuqizon të gjitha kufizimet sasiore, dhe masat me efekt të njëjtë me to, për importet e produkteve bujqësore dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Shqipëri.
2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria shfuqizon të gjitha kufizimet sasiore, dhe masat me efekt të njëjtë me to, për importet e produkteve bujqësore dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Komunitet.

NENI 27

Produktet bujqësore

1. 1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti shfuqizon detyrimet doganore dhe tarifatat me efekt të njëjtë me to për importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Shqipëri, përveç atyre të titujve nr. 0102, 0201, 0202, 1701, 1702 dhe 2204 të Nomenklaturës së Kombinuar.

Për produktet e trajtuara në Kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinuar, për të cilat Tarifa Doganore e Përbashkët parashikon zbatimin e tarifave doganore *ad valorem* dhe një tarifë doganore specifike, eliminimi zbatohet vetëm ndaj pjesës *ad valorem* të tarifës.

2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti zbaton hyrjen pa barra doganore për importet në Komunitet të produkteve që e kanë origjinën në Shqipëri të përfshira në titujt 1701 dhe 1702 të Nomenklaturës së Kombinuar, brenda kufirit të një kuote tarifore vjetore prej 1000 tonësh.

3. On Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria:
 - (a) shfuqizon detyrimet doganore të aplikueshme për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në Shtojcën II (a);
 - (b) redukton në mënyrë progresive detyrimet doganore për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në Shtojcën II (b) në përputhje me kalendarin e treguar për çdo produkt në atë Shtojcë;
 - (c) shfuqizon detyrimet doganore për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në Shtojcën II (c) brenda kufirit të kuotës tarifore të paraqitur për produktet në fjalë.

4. Protokoli 3 parashtrohet rregullimet që zbatohen për verërat dhe pijet alkoolike të përmendura aty.

NENI 28

Produktet e peshkimit

1. Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti heq të gjitha detyrimet doganore për importet e produkteve të peshkut dhe të peshkimit, përveç atyre të renditura në Shtojcën III që e kanë origjinën në Shqipëri. Produktet e renditura në Shtojcën III rregullohen nga dispozitat e paraqitura aty.
2. Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria nuk zbaton asnjë detyrim importi ose tarifa me efekt të njëjtë me to, për produktet e peshkut dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Komunitetin Europian.

NENI 29

Duke marrë parasysh volumin e tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkimit ndërmjet Palëve, ndjeshmëritë e veçanta të tyre, rregullat e politikave të përbashkëta të Komunitetit dhe politikave të Shqipërisë për bujqësinë dhe peshkimin, rolin e bujqësisë dhe peshkimit në ekonominë e Shqipërisë, si dhe pasojat e negociatave shumëpalëshe për tregtinë në kuadër të OBT-së, Komuniteti dhe Shqipëria do të shqyrtojnë në Këshillin e Stabilizim-Asociimit, jo më vonë se gjashtë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, produktet një nga një dhe mbi një bazë të ndërsjellë të rregullt dhe të përshtatshme, shqyrton gjithashtu mundësitë për t'i bërë konçesione të mëtejshme njëri-tjetrit me synim zbatimin e një liberalizimi më të madh të tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkimit.

NENI 30

Dispozitat e këtij Kapitulli nuk ndikojnë në asnjë mënyrë në aplikimin, mbi baza individuale, të masave më favorizuese të bëra prej njëres apo tjetres Palë.

NENI 31

Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti nenet 38 dhe 43, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e veçantë të tregjeve të bujqësisë dhe peshkimit, në rast se importet e produkteve që e kanë origjinën në njëren nga të dyja Palët, të cilat u nënshtrohen konçsioneve të dhëna sipas neneve 25, 27 dhe 28, shkaktojnë çrregullime serioze në tregjet ose mekanizmat rregullatorë të brendshëm në Palën tjetër, të dyja Palët do të fillojnë menjëherë konsultimet për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme. Në pritje të kësaj zgjidhjeje, Pala përkatëse mund të marrë masat që ajo i konsideron si të nevojshme.

—

—

— KAPITULLI III

—

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

NENI 32

Dispozitat e këtij Kapitulli zbatohen për tregtinë e të gjitha produkteve ndërmjet Palëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe këtu ose në Protokollet 1, 2 dhe 3.

NENI 33

Pezullimi

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen detyrime doganore të reja për importet ose eksportet, ose tarifa të reja me efekt të njëjtë me to, dhe nuk rriten as ato që zbatohen tashmë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.
2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen kufizime sasiore të reja për importet ose eksportet, apo masa të reja me efekt të njëjtë me to, dhe as nuk bëhen kufizime të metejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.
3. Pa cënuar konçesionet e bëra në bazë të nenit 26, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk kufizojnë në asnjë lloj mënyre ushtrimin e politikave bujqësore përkatëse të Shqipërisë dhe Komunitetit, ose marrjen e masave në kuadër të atyre politikave, për sa kohë që këto veprime nuk ndikojnë në regjimin e importeve në Shtojcat II dhe III.

NENI 34

Ndalimi i diskriminimit fiskal

1. Palët shmangin marrjen e masave ose shfuqizojnë praktikatat me natyrë fiskale të brendshme, ose ato ekzistuese që shkaktojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi diskriminim ndërmjet produkteve të njëjës Palë, dhe produkteve të ngjashme që e kanë origjinën në territorin e Palës tjetër.

2. Produktet e eksportuara në territorin e njëjës nga Palët nuk mund të përfitojnë nga rimbursimi për tatimin e tërthortë të brendshëm që kalon shumën e tatimit të tërthortë të vendosur mbi to.

NENI 35

Dispozitat lidhur me shfuqizimin e tarifave doganore për importet zbatohen gjithashtu edhe për tarifat doganore me natyrë fiskale.

NENI 36

Bashkimet doganore, zonat e tregtisë së lirë, rregullimet ndërkufitare

1. Kjo Marrëveshje nuk pengon mbajtjen apo krijimin e bashkimeve doganore, zonave të tregtisë së lirë apo rregullimet për tregtinë kufitare, përveçse në rastet kur ato ndryshojnë rregullimet tregtare të parashikuara nga kjo Marrëveshje.
2. Gjatë periudhave tranzitore të përcaktuara në nenin 19, kjo Marrëveshje nuk ndikon në zbatimin e rregullimeve privilegjuese specifike që rregullojnë lëvizjen e mallrave, qoftë të parashtruara në marrëveshjet kufitare të përfunduara më parë ndërmjet një ose më shumë Shtetesh Anëtare dhe Shqipërisë, ose që kanë rrjedhur prej marrëveshjeve dypalëshe të përcaktuara në Titullin III, të përfunduara nga Shqipëria për të promovuar tregtinë rajonale.

3. Konsultimet ndërmjet Palëve zhvillohen në Këshillin e Stabilizim-Asociimit lidhur me marrëveshjet që përshkruhen në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni dhe, sipas kërkesës, për çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me politikat e tyre përkatëse të tregtisë me vendet e treta. Veçanërisht në rastin e një vendi të tretë aderues në Komunitet, konsultime të tilla do të zhvillohen në mënyrë që të garantohet marrja parasysh e interesave të ndërsjella të Komunitetit dhe Shqipërisë të parashtruara në këtë Marrëveshje.

NENI 37

Dumpingu dhe Subvencioni

1. Asnjëra nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk i pengon palët që të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e tregtisë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni dhe nenit 38.

2. Nëse njëra nga Palët zbulon se në tregtinë me Palën tjetër po ndodh dumpingu dhe/ose subvencionim kundërvepruese, kjo palë mund të ndërmarrë masat e duhura ndaj kësaj praktike në përputhje me Marrëveshjen e OBT-së për Zbatimin e Nenit VI të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë 1994 dhe Marrëveshjen e OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese dhe legjislacionin e saj të brendshëm lidhur me të.

NENI 38

Klauzola të përgjithshme për masat mbrojtëse

1. Dispozitat e Nenit XIX GATT 1994 dhe Marrëveshja e OBT-së për Masat Mbrojtëse zbatohen ndërmjet palëve.
2. Kur cilido produkt i njëjës Palë që importohet në territorin e Palës tjetër në sasi të tilla dhe në kushte të tilla që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë:
 - dëme serioze ndaj industrisë vendase të produkteve të ngjashme ose që janë drejtpërsëdrejti konkurruese, në territorin e Palës importuese; ose
 - çrregullime serioze në cilindo sektor të ekonomisë apo vështirësi që mund të sjellin përkeqësim serioz të situatës ekonomike në një rajon të Palës importuese,

Pala importuese mund të marrë masat e përshtatshme sipas kushteve dhe në përputhje me procedurat e parashtruara në këtë nen.

3. Masat mbrojtëse dypalëshe kundrejt importeve të Palës tjetër nuk duhet të kapërcejnë nivelin e nevojshëm për riparimin e vështirësive që kanë lindur, dhe normalisht duhet të konsistojnë në pezullimin e reduktimit të mëtejshëm të çdo norme tarifore të aplikueshëm të parashikuar në këtë Marrëveshje për produktin përkatës, ose në rritjen e normës tarifore për atë produkt deri në një kufi maksimal që i korrespondon normës tarifore të statusit të Kombit Më Të Favorizuar (MFN) të aplikueshëm për të njëjtin produkt. Masa të tilla përmbajnë elementë të qartë që sjellin në mënyrë progresive eliminimin e tyre në fund të periudhës së vendosur si afat përfundimtar, dhe nuk merren për një periudhë më të gjatë se një vit. Në rrethana shumë të jashtëzakonshme mund të merren masa maksimumi për një periudhë deri në tre vjet. Asnjë masë mbrojtëse dypalëshe nuk zbatohet për importin e një produkti që më parë i është nënshtruar një mase të tillë, për një periudhë të paktën prej tre vjetësh që nga skadimi i masës.

4. Në rastet e përcaktuara në këtë nen, përpara marrjes së masave të parashikuara në të, ose në rastet kur aplikohet paragrafi 5 (b) i këtij neni, sapo të jetë e mundur, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, i japin Këshillit të Stabilizim-Asociimit të gjithë informacionin e përshtatshëm për të kërkuar një zgjidhje të pranueshme nga të dy Palët.

5. Për zbatimin e paragrafëve të mësipërm aplikohen dispozitat e mëposhtme:

(a) Vështirësitë që lindin nga situata e përmendur në këtë nen i kalohen për shqyrtim Këshillit të Stabilizim-Asociimit, i cili mund të marrë çfarëdolloj vendimi të nevojshëm për t'i dhënë fund këtyre vështirësive.

Në rast se Këshilli i Stabilizim-Asociimit ose Pala eksportuese, brenda tridhjetë ditëve pasi çështja i është kaluar për shqyrtim Këshillit të Stabilizim-Asociimit, nuk ka marrë një vendim për t'i dhënë fund këtyre vështirësive, ose kur nuk është arritur ndonjë zgjidhje tjetër e kënaqshme, Pala importuese mund të miratojë masat e duhura për të zgjidhur problemin në përputhje me këtë nen. Në përzgjedhjen e masave mbrojtëse u duhet dhënë përparësi atyre që ndikojnë më pak negative në funksionimin e rregullimeve të vendosura në këtë Marrëveshje. Masat mbrojtëse të zbatuara në përputhje me Nenin XIX GATT dhe Marrëveshjen e OBT-së për Masat Mbrojtëse ruajnë nivelin/hapësirën e preferencave të ofruara nga kjo Marrëveshje.

- (b) Kur rrethanat e jashtëzakonshme dhe shumë serioze që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë të pamundur informacionin ose shqyrtimin paraprak, sipas rastit, Pala përkatëse, në situatat e përcaktuara në këtë nen, mund të aplikojë menjëherë masa të përkohshme të nevojshme për të trajtuar situatën dhe informon njëherësh Palën tjetër për këtë.

Masat mbrojtëse i njoftohen menjëherë Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe do ti nënshtrohen konsultimeve periodike brenda këtij organi, në veçanti me synimin për të përcaktuar një kalendar veprimesh për anulimin e tyre sapo ta lejojnë rrethanat.

6. Në rast se Komuniteti ose Shqipëria ia nënshton importet e produkteve që rrezikojnë të shkaktojnë vështirësitë e përmendura në këtë nen, një procedure administrative që ka për qëllim sigurimin e shpejtë të informacionit për tendencën e rrjedhave tregtare, informon Palën tjetër.

NENI 39

Klauzola e pamjaftueshmërisë

1. Kur pajtueshmëria me dispozitat e këtij Titulli sjell:

- (a) një pamjaftueshmëri serioze, ose një rrezik për pamjaftueshmëri, artikujve ushqimorë ose produkteve të tjerë thelbësorë për Palën eksportuese; ose
- (b) rieksporimin në një vend të tretë të një produkti ndaj të cilit Pala eksportuese ruan kufizime sasiore për eksportin, tarifa, ose masa për eksportin që kanë efekt të njëjtë, dhe kur situatat e përmendura më sipër shkaktojnë, ose mund të shkaktojnë vështirësi të mëdha për Palën eksportuese,

kjo Palë mund të marrë masat e duhura në përputhje me kushtet dhe me procedurat e vendosura në këtë nen.

2. Në përzgjedhjen e masave u duhet dhënë përparësi atyre që ndikojnë më pak negativisht në funksionimin e rregullimeve të kësaj Marrëveshjeje. Këto masa nuk zbatohen në mënyrë të atillë që të përbëjnë diskriminim arbitrar e të pajustificueshëm, kur mbizotërojnë të njëjtat kushte, ose një kufizim i tërthortë për tregtinë dhe eliminohen kur kushtet nuk e justifikojnë më mbajtjen e tyre.

3. Përpara marrjes së masave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni ose, sapo të jetë e mundur, në rastet kur zbatohet paragrafi 4 i këtij neni, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, do t'i japin Këshillit të Stabilizim-Asociimit të gjithë informacionin përkatës, me qëllim për të kërkuar një zgjidhje të pranueshme për Palët. Palët brenda Këshillit të Stabilizim-Asociimit, mund të bien dakord për mjetet e nevojshme për t'i dhënë fund vështirësive. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje brenda tridhjetë ditëve pasi çështja i është kaluar Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Pala eksportuese mund të zbatojë masat e përmendura në këtë nen për eksportimin e produktit përkatës.

4. Kur rrethanat e jashtëzakonshme dhe shumë serioze që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë të pamundur informimin ose shqyrtimin paraprak, sipas rastit, Komuniteti ose Shqipëria cilado qoftë e interesuar, mund të zbatojnë sa më parë masa parandaluese të nevojshme për të trajtuar situatën dhe të informojnë Palën tjetër menjëherë për këtë.

5. Çdo masë e zbatuar sipas këtij neni i njoftohet menjëherë Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe i nënshtrohet konsultimeve periodike brenda këtij organi, në veçanti për të përcaktuar një kalendar veprimesh për eliminim e tyre sapo ta lejojnë rrethanat.

NENI 40

Monopolet shtetërore

Shqipëria do të përshtatë në mënyrë progresive të gjitha monopolet shtetërore me karakter tregtar për tu siguruar, që nga fundi i vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të mos ekzistojnë diskriminime ndërmjet qytetarëve të Shteteve Anëtare dhe Shqipërisë lidhur me kushtet sipas të cilave sigurohen dhe tregtohen mallrat. Këshilli i Stabilizim-Asociimit informohet për masat e miratuara për arritjen e këtij objektiv.

NENI 41

Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshjeje, Protokolli 4 parashton rregullat e origjinës për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 42

Kufizimet e autorizuara

Kjo Marrëveshje nuk përjashton ndalimet apo kufizimet e importeve, eksporteve ose mallrave tranzit të justifikuara në bazë të moralit publik, politikave publike, ose sigurisë publike; mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve; mbrojtjes së thesareve kombëtare me vlerë artistike, historike ose arkeologjike, ose mbrojtjes së pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, ose të rregullave lidhur me arin dhe argjendin. Megjithatë, ndalime ose kufizime të tilla nuk përbëjnë diskriminim arbitrar ose kufizim të tërthortë në tregtinë ndërmjet Palëve.

NENI 43

1. Palët bien dakord që bashkëpunimi administrativ është i domosdoshëm për zbatimin dhe kontrollin e trajtimit të privilegjuar të dhënë sipas këtij Titulli dhe nënvizojnë angazhimin e tyre për të luftuar parregullsitë dhe mashtrimin në dogana dhe çështje që lidhen me to.
2. Kur njëra Palë, në bazë të informacionit objektiv, ka konstatuar mungesën e bashkëpunimit administrativ dhe/ose parregullsi apo mashtrim sipas këtij Titulli, Pala e prekur mund të pezullojë përkohësisht trajtimin privilegjuar të produktit/produkteve përkatës në përputhje me këtë nen.

3. Për qëllimet e këtij neni, mungesa e bashkëpunimit administrativ do të thotë, përvec të tjerash:

- (a) mosrespektimi i përsëritur i detyrimeve për të verifikuar statusin e origjinës së produktit/produkteve përkatës;
- (b) refuzim i përsëritur ose vonesa të panevojshme për të kryer dhe/ose komunikuar rezultatet e një verifikimi pasues për vërtetësinë e origjinës;
- (c) refuzim i përsëritur ose vonesa të panevojshme në marrjen e autorizimit për kryerjen e misioneve të bashkëpunimit administrativ për të verifikuar vërtetësinë e dokumenteve ose saktësinë e informacionit të nevojshëm për dhënien e trajtimit preferencial në fjalë.

Për qëllimet e këtij neni, konstatimi i parregullsive ose mashtrimit mund të bëhet, përvec të tjerash, kur ka një rritje të shpejtë, pa shpjegime të kënaqshëm, të importeve të mallrave, që tejkalon nivelin e zakonshëm të prodhimit dhe kapacitetin eksportues të Palës tjetër, dhe që lidhet me informacionet objektive që kanë të bëjnë me parregullsitë ose mashtrimet.

4. Zbatimi i pezullimit të përkohshëm u nënshtrohet kushteve të mëposhtme:
- (a) Pala që ka bërë një konstatim, mbi bazën e informacionit objektiv, të mungesës së bashkëpunimit administrativ dhe/ose parregullsive ose mashtrimit, njofton, pa vonesa të panevojshme, Komitetin e Stabilizim-Asociimit për konstatimin e saj së bashku me informacionin objektiv dhe fillon konsultimet pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit, në bazë të gjithë informacioneve përkatëse dhe konstatimeve objektive, me synim arritjen e një zgjidhjeje të pranueshme nga të dyja Palët.
 - (b) Në rast se Palët kanë filluar konsultimet pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit si më sipër dhe kanë dështuar të bien dakord për një zgjidhje të pranueshme brenda tri muajsh pas njoftimit, Pala e interesuar mund të pezullojë përkohësisht trajtimin preferencial përkatës të produktit/produkteve përkatëse. Pezullimi i përkohshëm do ti njoftohet Komitetit të Stabilizim-Asociimit pa vonesa të tepruara.
 - (c) Pezullimet e përkohshme në bazë të këtij neni kufizohen deri në atë që masë është e nevojshme për të mbrojtur interesat financiare të Palës së interesuar. Ato nuk zgjasin për më shumë se gjashtë muaj, periudhë e cila mund të rinovohet. Pezullimet e përkohshme i njoftohen Komitetit të Stabilizim-Asociimit menjëherë pas miratimit të tyre. Ato u nënshtrohen konsultimeve periodike pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit, veçanërisht me synimin për t'i përfunduar ato sapo të mos ketë më kushte për zbatimin e këtyre pezullimevet.

5. Njëkohësisht me njoftimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit sipas paragrafit 4a) të këtij neni, Pala e interesuar duhet të publikojë një njoftim për importuesit në Fletoren e saj Zyrtare. Njoftimi për importuesit duhet të tregojë se në bazë të informacionit objektiv, për produktin përkatës është bërë një konstatim i mungesës së bashkëpunimit administrativ dhe/ose i parregullsive ose mashtrimeve.

NENI 44

Në rast gabimi të bërë nga autoritetet kompetente gjatë menaxhimit të duhur të sistemit privilegjues të eksportit dhe në veçanti gjatë zbatimit të dispozitave të protokollit të kësaj marrëveshjeje në lidhje me përkufizimin e origjinës së produkteve dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, kur ky gabim çon në pasoja lidhur me tarifën e importit, pala kontraktuese që përballet me këto pasoja mund t'i kërkojë Këshillit të Stabilizim-Asociimit shqyrtimin e mundësive për miratimin e të gjitha masave të duhura që synojnë zgjidhjen e situatës.

NENI 45

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet pa cënuar aplikimin e dispozitave të së drejtës Komunitare për Ishujt Kanarie.

TITULLI V

LËVIZJA E PUNONJESVE, NDËRMARRJE,
OFRIMI I SHËRBIMEVE, KAPITALI

– KAPITULLI I

–

LËVIZJA E PUNONJËSVE

NENI 46

1. Në përputhje me kushtet dhe modalitetet e zbatueshme në çdo Shtet Anëtar:
 - trajtimi i akorduar punonjësve që janë shtetas shqiptarë të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar nuk përmban asnjë formë diskriminimi bazuar në kombësi, për sa u përket kushteve të punës, shpërblimit apo shkarkimit nga puna, krahasuar këto me shtetasit e tij;
 - bashkëshorti/bashkëshortja dhe fëmijët rezidentë të ligjshëm të një punonjësi të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar, me përjashtim të punonjësve sezonalë dhe të punonjësve që i nënshtrohen marrëveshjet dypalëshe nën përcaktimin e nenit 47, në rast se nuk parashikohet ndryshe nga marrëveshjet e tilla, gëzojnë akses në tregun e punës së Shtetit Anëtar përkatës, gjatë periudhës së qëndrimit të autorizuar për punësim të punonjësit.

2. Shqipëria, në përputhje me kushtet dhe modalitetet në atë vend, u akordon të njëjtin trajtim siç përcaktohet në paragrafin 1 punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar dhe janë ligjërisht të punësuar në territorin e saj, ashtu si edhe bashkëshortit/bashkëshortes dhe fëmijëve të tyre që janë rezidentë të ligjshëm në atë vend.

NENI 47

1. Duke marrë parasysh situatën e tregun e punës në Shtetet Anëtare, në varësi të legjislacionit të tyre dhe në pajtueshmëri me rregullat në fuqi në Shtetet Anëtare në fushën e lëvizjes së punonjësve:

- lehtësirat ekzistuese të aksesave për punësim për shtetasit shqiptarë të akorduara nga Shtetet Anëtare, me anë të marrëveshjeve dypalëshe, duhet të ruhen dhe nëse është e mundur të përmirësohen;
- Shtetet e tjera Anëtare shikojnë mundësitë e realizimit të marrëveshjeve të tilla të ngjashme.

2. Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të shikojë mundësinë për përmirësime të tjera, duke përfshirë lehtësira për akses në trajnimet profesionale, në përputhje me rregullat dhe procedurat në fuqi në Shtetet Anëtare, dhe duke marrë parasysh situatën në tregun e punës në Shtetet Anëtare dhe në Komunitet.

NENI 48

1. Do të vendosen rregulla për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit me nënshtetësi shqiptare, të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar dhe për pjesëtarët e familjeve të tyre që janë ligjërisht rezidentë aty. Për këtë qëllim, një vendim i Këshillit të Stabilizim-Asociimit, i cili nuk duhet të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje dypalëshe ku këto të fundit parashikojnë një trajtim më të favorshëm, do të vendosin dispozitat e mëposhtme:
 - të gjitha periudhat e sigurimeve, punësimit apo qëndrimit të përfunduara nga punonjës të tillë në Shtete të ndryshme Anëtare duhet të mblidhen bashkë për qëllimin e dhënies së pensioneve dhe pagave vjetore në lidhje me pleqërinë, paaftësinë fizike dhe vdekjen dhe për qëllim përkujesjeje shëndetësore për këtë kategori punonjësish dhe familjarët e tyre;
 - pensionet ose pagesat vjetore në lidhje me pleqërinë, vdekjen, aksidentet në punë ose sëmundjet profesionale, ose invaliditeti që shaktohet nga puna, me përjashtim të përfitimeve jo-kontribuuese, transferohen pa pengesë në masën e aplikuar sipas legjislacionit të Shtetit ose Shteteve Anëtare debitor;
 - punonjësit në fjalë marrin asistencë financiare për pjesëtarët e familjeve të tyre siç përcaktohet më sipër;
2. Shqipëria u akordon punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar dhe ligjërisht të punësuar në territorin e saj, dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre rezidentë të ligjshëm aty, të njëjtin trajtim siç specifikohet në pikën e dytë dhe të tretë të paragrafit 1.

– KAPITULLI II

–

NDËRMARRJE

NENI 49

Për qëllimet e kësaj Marrëveshje:

- (a) "Shoqëri Komunitare" ose "shoqëri shqiptare" nënkupton përkatësisht një shoqëri të themeluar në bazë të legjislacionit, përkatësisht të një Shteti Anëtar ose të Shqipërisë, dhe që ka zyrat e saj ose administratën qendrore apo vendin parësor të biznesit të regjistruara përkatësisht në territorin e Komunitet ose të Shqipërisë.

Megjithatë, në rast se shoqëria, e krijuar në përputhje me legjislacionin, përkatësisht të një Shteti Anëtar ose të Shqipërisë, ka vetëm zyrat e saja të regjistruara në përkatësisht në territorin e Komunitetit ose të Shqipërisë, atëherë shoqëria konsiderohet si një shoqëri përkatësisht Komunitare ose shqiptare, n.q.s veprimtaritë e saj vendosin një lidhje të vazhdueshme dhe të vërteta me ekonominë përkatësiht te një prej Shteteve Anëtare ose të Shqipërisë.

- (b) "Filial" të një shoqërie nënkupton një shoqëri e cila kontrollohet efektivisht nga kompania e parë.

- (c) "Degë" e një shoqërie nënkupton një vend biznesi i cili nuk gëzon personalitet juridik dhe që ka pamjen e vazhdimësisë, si një shtrirje të shoqërisë mëmë, që ka një menaxhim dhe është e pajisur materialisht për të negociuar çështje biznesi me Palët e treta, kështu që këto të fundit, ndonëse janë në dijeni se në rast nevojë do të ekzistojë një lidhje juridike me organin mëmë, zyra qendrore e së cilës ndodhet jashtë vendit, nuk janë të detyruara të bashkëpunojnë direkt me një organ të tillë mëmë, por mund të përfundojnë veprimtaritë e biznesit në vendin e biznesit që përbën shtrirjen e shoqërisë mëmë.
- (d) "Ndërmarrje" nënkupton:
- (i) për sa u përket shtetasve, të drejtën për të ndjekur veprimtari ekonomike si persona të vetë-punësuar dhe për të krijuar sipërmarrje, veçanërisht shoqëri, të cilat faktikisht kontrollohen prej tyre. Vetë-punësimi dhe sipërmarrjet tregtare nga shtetasit nuk shtrihen në kërkimin apo pranimin e punësimit në tregun e punës ose të arkordojnë të drejtën e aksesit në tregun e punës të një pale tjetër. Dispozitat e këtij Kapitulli nuk zbatohen mbi personat të cilët nuk janë ekskluzivisht të vetë-punësuar;
 - (ii) për sa u përket shoqërive Komunitare dhe shqiptare, të drejtën për të ndjekur veprimtari ekonomike nëpërmjet ngritjes së filialeve dhe degëve përkatësisht në Shqipëri ose Komunitet.
- (e) "Veprimtari" nënkupton ushtrimin e veprimtarive ekonomike.
- (f) "Veprimtari ekonomike" në parim përfshin veprimtaritë me një karakter industrial, tregtar dhe profesional, si dhe veprimtaritë artizanale.

- (g) "Shtetas Komunitar" dhe "shtetas shqiptar" nënkuptojnë përkatësisht një person fizik i cili është shtetas i një prej Shteteve Anëtare ose i Shqipërisë.
- (h) Për sa i përket transportit detar ndërkombëtar, duke përfshirë veprime intermodale që përfshijnë një transport tranzit me anë të detit, shtetasit e Shtetit Anëtar ose të Shqipërisë të vendosur jashtë Komunitetit ose Shqipërisë përkatësisht, ashtu si dhe kompanitë detare të vendosura jashtë Komunitetit ose Shqipërisë dhe të kontrolluara nga shtetas të një Shteti Anëtar apo shtetas të Shqipërisë respektivisht, jenë gjithashtu përfitues të dispozitave të këtij Kapitulli dhe të Kapitullit III, në qoftë se mjetet e tyre të lundrimit janë regjistruar në atë Shtet Anëtar ose në Shqipëri përkatësisht, në përputhje me legjislacionet e tyre përkatës.
- (i) "Shërbime financiare" nënkuptojnë ato veprimtari të përshkruara në Shtojcën IV. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të zgjerojë ose ndryshojë fushën e zbatimit të kësaj Shtojce.

NENI 50

1. Shqipëria lehtësonë ngritjen e veprimtarive, nga shoqëri dhe shtetas Komunitarë, në territorin e saj. Për këtë qëllim, ajo garanton me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje:

- (i) për sa i përket ndërmarrjeve të shoqërive Komunitare, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar shoqërive të saj ose shoqërive të një vendi të tretë, cilido qoftë më i mirë, dhe;

- (ii) për sa u përket veprimtarive të filialeve dhe degëve të shoqërive Komunitare në Shqipëri, pas vendosjes së tyre, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar degëve dhe shoqërive të saj ose të një filiali dhe dege të një shoqërive të një vendi të tretë, cilido qoftë më i mirë.
2. Palët nuk miratojnë asnjë rregull apo masa të reja të cilat sjellin diskriminim për sa i përket ndërmarrjeve të shoqërive Komunitare ose shqiptare në territorin e tyre ose në lidhje me veprimtaritë e këtyre shoqërive, pas vendosjes, në krahasim me shoqëritë e tyre.
3. Komuniteti dhe vendet e tij Anëtare garantojnë, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje:
- (i) për sa i përket vendosjes së shoqërive shqiptare, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar nga Shtetet Anëtare shoqërive të tyre ose shoqërive të një vendi të tretë, cilido të jetë më i mirë; dhe
 - (ii) për sa u përket veprimtarive të filialeve dhe degëve të shoqërive shqiptare, të vendosura në territorin e tyre, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar nga Shtetet Anëtare degëve dhe shoqërive të tyre ose të një filiali dhe dege të një shoqërie të një vendi të tretë, të vendosura në territorin e tyre, cilido të jetë më i mirë.
4. Pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit vendos modalitetet për shtrirjen e dispozitave të mësipërme në lidhje me ndërmarrjet e shtetasve të të dyja Palëve të kësaj Marrëveshjeje për të filluar veprimtari ekonomike si persona të vetë-punësuar.

5. Pavarësisht nga parashikimet e këtij Neni:
- (a) Filialet dhe degët e shoqërive Komunitare, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje gëzojnë të drejtën për të përdorur dhe marrë me qira pasuri të patundshme në Shqipëri;
 - (b) Filialet dhe degët e shoqërive Komunitare gëzojnë gjithashtu të drejtën për të fituar dhe gëzuar të drejta pronësie mbi pasuritë e patundshme ashtu si shoqëritë shqiptare, si edhe për sa u përket të mirave publike me interes të përbashkët, aty kur këto të drejta konsiderohen të nevojshme për kryerjen e veprimtarive ekonomike për të cilat ato janë themeluar, duke përfshirë burimet natyrore, tokat bujqësore, pyjet, toka pyjore. Shtatë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të vendosë modalitetet për shtrirjen e të drejtave sipas këtij paragrafi dhe në sektorët e përjashtuar.

NENI 51

1. Në përputhje me dispozitat e nenit 50, me përjashtim të shërbimeve financiare të përshkruara në Shtojcën IV, secila Palë mund të rregullojë ngritjen dhe veprimtarinë e kompanive dhe shtetasve në territorin e saj, për sa kohë që këto rregulla nuk krijojnë diskriminim për shoqëritë dhe shtetasit e Palës tjetër në krahasim me shtetasit dhe shoqëritë e saj.

2. Për sa u përket shërbimeve financiare, pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, njëra Palë nuk ndaloheq të marrë masa për arsye kujdesi paraprak, përfshirë mbrojtjen e investitorëve, depozituesve, personave të siguruar ose personave të cilët kanë detyrime financiare për te shlyer tek një ofruer i shërbimeve financiare, ose për të siguruar integritetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Masa të tilla nuk përdoren si një mënyrë për të shmangur detyrimet e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Në këtë Marrëveshje asgjë nuk interpretohet në mënyrë të atillë që të detyrojë një Palë për të bërë publike informacione lidhur me punët dhe llogaritë e klientëve të veçantë ose informacione konfidenciale që disponojnë entet publike.

NENI 52

1. Pa cënuar Marrëveshjen Shumëpalëshe për Vendosjen e një Zone të Përbashkët Europiane të Aviacionit dispozitat e këtij Kapitulli nuk zbatohen për shërbimet e transportit ajror, shërbimet e transportit në ujërat e brendshme dhe shërbimet detare të kabotazhit.

2. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të bëjë rekomandime për përmirësimin e ndërmarrjeve dhe veprimtarive në zonat e trajtuara nga paragrafi 1.

NENI 53

1. Dispozitat e nenit 50 dhe 51 nuk përjashtojnë zbatimin nga një Palë të rregullave të veçanta lidhur me vendosjen dhe veprimtarinë në territorin e saj të degëve të kompanive të një Pale tjetër jo të krijuara në territorin e Palës së parë, të cilat justifikohen me dallime legislative ose teknike ndërmjet këtyre degëve krahasuar këto me degët e shoqërive të vendosura në territorin e saj ose për sa u përket shërbimeve financiare, për arsye kujdesi paraprak.

2. Trajtimi i diferencuar nuk kalon përtej masës që shihet e nevojshme si rrjedhojë e këtyre dallimeve legislative dhe teknike, ose për sa u përket shërbimeve financiare, për arsye kujdesi paraprak.

NENI 54

Në mënyrë që të lehtësojë shtetasit e Komunitetit dhe shtetasit shqiptarë për të filluar dhe ndjekur veprimtari profesionale të përshtatshme përkatësisht në Shqipëri dhe në vendet e Komunitetit, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të shqyrtojë se cilat janë hapat e nevojshëm për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve. Këshilli mund të marrë të gjithë masat e nevojshme për këtë qëllim.

NENI 55

1. Një kompani Komunitare ose një kompani shqiptare e vendosur në territorin e Shqipërisë ose të Komunitetit përkatësisht gëzon të drejtën të punësojë, ose të ketë të punësuar nëpërmjet një prej filialeve ose degëve të saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin pritës të vendosjes së kompanisë, përkatësisht në territorin e Shqipërisë ose të Komunitetit, punonjës të cilët janë përkatësisht shtetas të Shteteve Anëtare dhe të Shqipërisë, me kusht që të jenë personel kyç siç përcaktohet në paragrafin 2 dhe që janë të punësuar ekskluzivisht nga kompani, filiale ose degë. Leja e punës dhe e qëndrimit e këtyre punonjësve mbulon vetëm periudhën e punësimit.

2. Personeli kyç i kompanive të sipërpërmendura, referuar më poshtë si “organizata”, janë “të transferuar brenda-kompanisë” siç përcaktohet në pikën c) të këtij paragrafi në kategoritë e mëposhtme, me kusht që organizata të jetë një person juridik dhe që personat e interesuar të kenë qenë të punësuar prej saj ose partnerë me të (por jo aksionerë me shumicën e aksioneve), të paktën gjatë atij viti që paraprin një lëvizje e tillë:

(a) Personat që punojnë në një pozicion drejtues në një organizatë, të cilët drejtojnë kryesisht menaxhimin e ndërmarrjes, dhe që mbikëqyren në mënyrë të përgjithshme ose marrin udhëzime kryesisht nga bordi i drejtorëve ose i aksionerëve të biznesit ose ekuivalentëve të tyre, duke përfshirë këtu:

- drejtimin e ndërmarrjes ose të një departamenti apo nënndarjeje të saj;
- mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së nëpunësëve të tjerë si të mbikëqyrësve, specialistëve ose menaxherëve;

- kompetencës që personalisht të të punësojë dhe shkarkojë, ose të rekomandojë rekrutimin, shkarkimin ose veprime të tjera në lidhje me personelin;
- (b) Persona të punësuar në një organizatë, të cilët zotërojnë njohuri të veçanta që janë thelbësore në shërbimet e ndërmarrjes, mjetet kërkimore, teknika ose menaxhim. Vlerësimi i njohurive të tilla mund të pasqyrojë, përveç njohurive specifike të cilat lidhen me ndërmarrjen, një nivel të lartë kualifikimi që i referohet një lloj pune ose tregtie ku nevojiten njohuri teknike të veçanta, përfshirë edhe anëtarësimin në një profesion të akredituar;
- (c) Një "i transferuar brenda-kompanisë" përkufizohet si person fizik i punësuar brenda një organizate në territorin e një Pale, dhe i cili përkohësisht është transferuar në kontekst e vazhdimit të veprimtarive ekonomike në territorin e Palës tjetër; organizata përkatës duhet të ketë vendin parësor të biznesit të saj në territorin e njëres Pale dhe transferimi të ndodhë në një ndërmarrje (degë, filial) të asaj organizate, e cila ndjek me efikasitet veprimtari ekonomike të ngjashme në territorin e Palës tjetër.
3. Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm në territorin e Komunitetit ose Shqipërisë, përkatësisht i shtetasve shqiptarë ose Komunitarë, lejohet, atëherë kur këta përfaqësues të kompanive janë persona të punësuar në një pozicion drejtues, të përcaktuar në paragrafin 2(a) më sipër, brenda një kompanie dhe janë përgjegjës për ngritjen e një filiali Komunitar, ose degë të një kompanie shqiptare, ose të një filiali shqiptar, ose degë të një kompanie Komunitare përkatësisht në një Shtet Anëtar ose në Shqipëri, atëherë kur:
- këta përfaqësues nuk janë të angazhuar në shitjet e drejtpërdrejta apo në ofrimin e shërbimeve, dhe
 - kompania ka vendin parësor të biznesit të saj, përkatësisht jashtë Komunitetit ose Shqipërisë, dhe nuk ka përfaqësues, zyrë, degë ose filiale të tjera, përkatësisht në atë Shtet Anëtar ose në Shqipëri.

ARTICLE 56

Gjatë pesë viteve të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria mund të zbatojë, mbi bazë kalimtare ,masa të cilat devijojnë nga dispozitat e këtij Kapitulli, për sa i përket ndërmarrjeve të kompanive Komunitare dhe shtetasve të industrive të caktuara të cilat:

- janë në proces ristrukturimi, ose janë duke u përballur me vështirësi serioze, veçanërisht ku këto sjellin probleme sociale të rënda në Shqipëri, ose
- përballen me humbjen ose reduktimin drastik të tregut të zotëruar nga kompanitë ose shtetasit shqiptarë, në një sektor të caktuar ose industri në Shqipëri, ose
- janë industri të cilat po krijohen rishtas në Shqipëri.

Masa të tilla:

- (i) pushojnë së vepruari jo më vonë se shtatë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;
- (ii) duhet të jenë të arsyeshme dhe të nevojshme për të përmirësuar situatën, dhe
- (iii) nuk sjellin diskriminim ndaj aktiviteteve të kompanive ose shtetasve Komunitare të vendosura tashmë në Shqipëri në kohën e fillimit të një mase të dhënë, në krahasim me kompanitë ose shtetasit shqiptarë.

Në hartimin dhe zbatimin e masave të tilla, Shqipëria u akordon trajtim të privilegjuar kompanive dhe shtetasve Komunitare kurdoherë që është e mundur, dhe në asnjë rast trajtim më pak të favorshëm se sa ai që i është akorduar kompanive dhe shtetasve të cilido vendi të tretë. Para se të miratojë masa të tilla, Shqipëria konsultohet me Këshillin e Stabilizim-Asociimit dhe i vë në zbatim vetëm pas përfundimit të një periudhe një mujore, pasi është njoftuar Këshilli i Stabilizim-Asociimit për masat konkrete që do të zbatojë Shqipëria, me përjashtim të rasteve kur rreziku i dëmeve të pariparueshme kërkon marrjen e masave urgjente, rast në të cilin Shqipëria konsultohet me Këshillin e Stabilizim-Asociimit menjëherë pas marrjes së këtyre masave.

Me përfundimin e vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria mund të paraqesë ose mbajë masa të tilla vetëm me autorizimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe sipas kushteve të përcaktuara nga ky i fundit.

–

– KAPITULLI III

–

OFRIMI I SHËRBIMEVE

NENI 57

1. Palët angazhohen, në përputhje me dispozitat e mëposhtme që të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të lejuar në mënyrë progresive ofrimin e shërbimeve nga kompanitë ose shtetasit Komunitarë ose shqiptarë, të cilët janë vendosur në një Palë të ndryshme nga ajo e personit për cilin synohet shërbimi.

2. Në përputhje me procesin e liberalizimit të përmendur në paragrafin 1, Palët lejojnë lëvizjen e përkohshme të personave fizikë të cilët japin shërbime ose që janë punësuar nga afruesi i shërbimeve si personel kyç, sië përcaktohet në nenin 55 , përfshirë personat fizikë të cilët janë përfaqësues të një kompani Komunitare ose shqiptare apo të një shtetasi Komunitar ose shqiptar dhe të cilët kërkojnë hyrje të përkohshme për të negociuar shitjen e shërbimeve ose lidhjen e marrëveshjeve për shitjen e shërbimeve për afruesin e shërbimeve në fjalë, ku këta përfaqësues nuk merren vetë me shitje të drejtpërdrejta për publikun e gjerë ose me ofrimin e shërbimeve.

3. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të marrë masat e nevojshme për të zbatuar në mënyrë progresive dispozitat në paragrafin 1. Do të merret parasysh progresi i arritur nga Palët në përafrimin e legjislacionit të tyre.

NENI 58

1. Palët nuk ndërmarrin masa ose veprime të tilla, që i bëjnë kushtet për ofrimin e shërbimeve nga shtetasit ose shoqëritë Komunitare ose shqiptare të cilët janë vendosur në një Palë të ndryshme nga ajo e personit të cilit i drejtohet shërbimi, më kufizuese krahasuar këto me situatën ekzistuese ditën përpara hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

2. Nëse një prej Palëve është e mendimit se masat e zbatuara nga Pala tjetër pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes çojnë në një situatë e cila kufizon në mënyrë më të ndjeshme ofrimin e shërbimeve krahasuar këto me situatën ekzistuese ditën hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Pala e parë mund t'i kërkojë Palës tjetër që të konsultohet.

NENI 59

Në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transportit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë, aplikohen dispozitat e mëposhtme:

1. Lidhur me transportin e brendshëm tokësor, Protokollin 5 parashton rregullat e aplikueshme në marrëdhëniet ndërmjet Palëve për të siguruar, sidomos trafik rrugor tranzit të pakufizuar përmes Shqipërisë dhe Komunitetit në tërësi, zbatimin efektiv të parimit të mos-diskriminimit dhe harmonizimit progresiv të legjislacionit shqiptar për transportin me atë Komunitar.

2. Lidhur me transportin ndërkombëtar detar, Palët angazhohen të zbatojnë me efektivitet parimin e lejit të aksesit të pakufizuar në treg dhe trafik mbi baza tregtare, si edhe të respektojnë detyrimet ndërkombëtare dhe europiane në fushën e standardeve të sigurisë, sigurimit dhe të mjedisit.

Palët konfirmojnë angazhimin e tyre për një mjedis të lirë konkurrues, si një veçori thelbësore në transportin detar ndërkombëtar.

3. Në zbatimin e parimeve të paragrafit 2, Palët 2:

(a) nuk do të paraqesin klauzola për ngarkesa të përbashkëta në marrëveshjet e ardhshme dypalëshe me vendet e treta;

(b) shfuqizojnë, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha masat e njëanshme si dhe pengesat administrative, teknike dhe të tjera të cilat mund të kenë efekte kufizuese apo diskriminuese në ofrimin e lirë të shërbimeve në transportin detar ndërkombëtar.

(c) secila Palë nuk duhet të ofrojë përvec të tjerash, një trajtim jo më pak të favorshëm për anijet e zotëruara nga shtetas ose shoqëri të Palës tjetër, krahasuar kjo me trajtimin e dhënë ndaj anijeve të Palës në fjalë, për sa i përket aksesit në porte të hapura për tregtinë ndërkombëtare, përdorimit të infrastrukturës dhe shërbimeve ndihmëse detare në porte, ashtu si dhe tarifave dhe taksave, lehtësirave doganore e caktimin e vendeve të ankorimit dhe të lehtësirave për ngarkim-shkarkim.

4. Me qëllim sigurimin e një zhvillimi të bashkërenduar dhe liberalizim progresiv të transportit ndërmjet Palëve të përshtatur sipas nevojave tregtare të përbashkëta, kushtet për aksesin e ndërsjellë në tregun e transportit ajror do të trajtohen në marrëveshje të veçanta të cilat do të negociohen ndërmjet Palëve.

5. Para se të bëhet përfundimi i marrëveshjes së përmendur në paragrafin 4, Palët nuk marrin asnjë masë ose veprim që është më kufizues ose diskriminues krahasuar këto me situatën ekzistuese para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

6. Shqipëria do të përshtasë legjislacionin e saj, duke përfshirë gjithashtu rregullat administrative, teknike dhe të tjera, me ato Komunitare ekzistuese në çdo kohë, në fushën e transportit ajror, detar dhe tokësor të brendshëm për aq kohë sa kjo u shërben qëllimeve të liberalizimit dhe aksesit të ndërsjellë në tregjet e Palëve dhe lehtëson lëvizjen e pasagjerëve dhe të mallrave.

7. Bazuar në progresin e përbashkët në arritjen e objektivave të këtij Kapitulli, Këshilli i Stabilizim-Asociimit shqyrton mënyrat për krijimin e kushteve të nevojshme për përmirësimin e lirisë në ofrimin e shërbimeve në transportin ajror dhe tokësor të brendshëm.

– KAPITULLI IV

–

PAGESAT RRJEDHESE DHE LEVIZJA E KAPITALIT

NENI 60

Palët angazhohen të autorizojnë, në monedha të këmbyeshme lirshëm, çdo pagesë apo transfertë në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë ,në përputhje me dispozitat e Nenit VIII të Neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

NENI 61

1. Në lidhje me transaksionet e kapitalit dhe llogaritë financiare të bilancit të pagesave, që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, Palët sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investime të drejtpërdrejta të kryera nga kompani të krijuara në përputhje me legjislacionin e vendit pritës, dhe me investime të kryera në përputhje me dispozitat e Kapitullit II të Titullit V, si dhe likuidimin ose riatdhesimin e këtyre investimeve dhe të çdo përfitimi që rrjedh prej tyre.
2. Në lidhje me transaksionet në e kapitalit dhe llogaritë financiare të bilancit të pagesave, nga hyrja në fuqi të Marrëveshjes, Palët sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit për sa u përket kredive që lidhen me transaksionet tregtare ose me sigurimin e shërbimeve ku merr pjesë një rezident i një prej Palëve, dhe të huave financiare e kredive, me afat maturimi më të gjatë se një vit.

Që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria autorizon, duke shfrytëzuar në mënyrë maksimale dhe të përshtatshme procedurat dhe kuadrin ligjor, blerjen e pasurive të patundshme në Shqipëri nga shtetas të Shteteve Anëtare të Bashkimit European, me përjashtim të kufizimeve të parashikuara në Kalendarin e Shqipërisë për Angazhime Specifike sipas Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë për Shërbime (GATS). Brenda shtatë vitesh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria në mënyrë progresive do të përafrojë legjislacionin e saj lidhur me të drejtën e blerjes së pasurive të patundshme në Shqipëri nga shtetas të Shteteve Anëtare të Bashkimit European për t'iu siguruar trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që u sigurohet shtetasve shqiptarë. Pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të shqyrtojë modalitetet për eliminimin progresive të këtyre kufizimeve.

Palët gjithashtu do të sigurojnë, që nga viti i pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, lëvizjen e lirë të kapitalit për investimet në letrat me vlerë e huat financiare dhe kreditë me një afat maturimi më të shkurtër se një vit.

3. Pa cënuar paragrafin 1, Palët nuk do të paraqesin kufizime të reja në lëvizjen e kapitalit dhe pagesave rrjedhëse ndërmjet rezidentëve të Komunitetit dhe Shqipërisë, dhe nuk do t'i bëjnë marrëveshjet ekzistuese më tepër kufizuese.

4. Pa cënuar dispozitat e nenit 60 dhe as të këtij neni, në rrethana të jashtëzakonshme, kur lëvizjet e kapitalit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë shkaktjnë ose kërcënojnë të shkaktjnë vështirësi serioze për funksionimin e politikave të kursit të këmbimit ose politikave monetare në Komunitet ose Shqipëri, Komuniteti dhe Shqipëria përkatësisht, mund të marrin masa mbrojtëse lidhur me lëvizjet e kapitalit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë për një periudhë jo më të gjatë se një vit në qoftë se masa të tilla janë më se të nevojshme.

5. Në dispozitat e mësipërme asgjë nuk duhet interpretuar si kufizim i të drejtave të operatorëve ekonomikë të Palëve për të përfituar nga një trajtim më i favorshëm që mund të parashikohet në ndonjë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ekzistuese, pjesë e së cilës janë Palët e kësaj Marrëveshjeje.

6. Palët konsultohen ndërmjet tyre për të lehtësuar lëvizjen e kapitalit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë, në mënyrë që të promovohen objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

NENI 62

1. Gjatë tri viteve të para që nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët marrin masa që lejojnë krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e mëtejshëm gradual të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e lirë të kapitalit.

2. Në përfundim të vitit të tretë që nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit përcakton modalitetet për zbatimin e plotë të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e kapitalit.

—
—
KAPITULLI V—
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 63

1. Dispozitat e këtij Titulli zbatohen duke iu nënshtruar kufizimeve për arsye të politikave publike, sigurisë publike ose shëndetit publik.
2. Ato nuk zbatohen për veprimtari të cilat kanë lidhje, edhe rastësisht, me ushtrimin e autoritetit zyrtar në territorin e secilës prej Palëve.

NENI 64

Për qëllimin e këtij Titulli, në këtë Marrëveshje asgjë nuk ndalon Palët të zbatojnë ligjet dhe aktet e tyre nënligjore për sa i përket hyrjes dhe qëndrimit, punësimit, kushteve të punës, vendosjes së personave fizikë dhe ofrimit të shërbimeve, me kusht që, duke vepruar në këtë mënyrë, ata nuk i zbatojnë këto masa në mënyrë të tillë që të anulojnë ose të dëmtojnë përfitimet e secilës prej Palëve sipas kushteve të një dispozite të veçantë të kësaj Marrëveshjeje. Kjo dispozitë nuk çënon zbatimin e nenit 63.

NENI 65

Kompanitë të cilat kontrollohen dhe janë ekskluzivisht nën pronësinë e përbashkët të shtetasve ose kompanive shqiptare dhe të shtetasve ose kompanive Komunitare, janë gjithashtu subjekt i dispozitave të këtij Titulli..

NENI 66

1. Trajtimi i Kombit më të Favorizuar, i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij Titulli nuk zbatohet mbi avantazhet e tatimeve që Palët sigurojnë ose do të sigurojnë në të ardhmen në bazë të marrëveshjeve që kanë për qëllim shmangien e tatimit të dyfishtë ose rregullime të tjera tatimesh.
2. Asnjë prej dispozitave të këtij Titulli nuk duhet të interpretohen si masa që parandalojnë miratimin ose imponimin nga Palët, të masave të cilat synojnë parandalimin e shmangieve ose evazionin e tatimeve në vijim të dispozitave tarifore të marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe formave të tjera tatimore ose legjislacionin e brendshëm fiskal.
3. Asnjë prej dispozitave të këtij Titulli nuk duhet interpretuar si masa që parandalojnë Shtetet Anëtare ose Shqipërinë të zbatojnë dispozitat përkatëse të legjislacioneve të tyre fiskalë, për dallimin e taksapaguesve të cilët nuk gjenden në situata të njëjta, sidomos në lidhje me vendin e tyre të qëndrimit.

NENI 67

1. Palët përpiqen kurdo të jetë e mundur, të shmangin vendosjen e masave kufizuese, përfshirë masat për kufizimin e importeve, për të mbrojtur bilancin e pagesave. Pala e cila miraton masa të tilla duhet t'i paraqesë sa më shpejt të jetë e mundur Palës tjetër një kalendar për heqjen e tyre.
2. Në rastin kur një ose më shumë Shtete Anëtare apo Shqipëria gjenden në një situatë tejet të vështirë të bilancit të pagesave, ose pranë një rreziku të afërt, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, në përputhje me kushtet e vendosura nga Marrëveshja e OBT-së, miratojnë masa kufizuese, përfshirë masa mbi importet, të cilat duhet të jenë për një kohë të kufizuar dhe nuk mund të masat veçanërisht të nevojshme për rregullimin e situatës së bilancit të pagesave. Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, informon menjëherë Palën tjetër.
3. Asnjë masë kufizuese nuk zbatohet për transfertat lidhur me investimet, dhe sidomos lidhur me riatdhesimin e shumave të investuara ose të riinvestuara apo çdo lloj të ardhurash që rrjedhin nga to.

NENI 68

Dispozitat e këtij Titulli përshtaten progresivisht, veçanërisht në kuadër të kërkesave që vijnë nga Neni V i Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë në Shërbime (GATS).

NENI 69

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk çenojnë zbatimin prej secilës Palë të masave të nevojshme për të parandaluar shmangien e masave lidhur me aksesin e vendeve të treta në tregun e tyre nëpërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

TITULLI VI

PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT, IMPONIMI I LIGJEVE DHE RREGULLAT E
KONKURRENCËS

NENI 70

1. Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.
2. Ky përafrim fillon në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementët e *acquis* të Komunitetit të përmendura në këtë Marrëveshje brenda periudhës tranzitore të përcaktuar në Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjatë fazës së parë të përcaktuar në Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, përafrimi do të përqendrohet në elementët thelbësorë të *acquis* së Tregut të Brendshëm ashtu si dhe në fusha të tjera të rëndësishme si konkurrenca, të drejtat mbi pronësinë intelektuale, industriale dhe tregtare, prokurimi publik, standardet dhe certifikimi, shërbimet financiare, transporti detar dhe tokësor – duke i kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë dhe standardeve mjedisore si dhe aspekteve sociale –, ligji për kompanitë tregtare, kontabiliteti, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e të dhënave, shëndeti dhe siguria në punë dhe mundësi të barabarta. Gjatë fazës së dytë, Shqipëria përqendrohet në pjesët e mbetura të *acquis*.

Përafrimi kryhet në bazë të një programi, për të cilin do të bihet dakord,, ndërmjet Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe Shqipërisë.

4. Shqipëria, në pajtim me Komisionin e Komuniteteve Europiane, do të përcaktojë modalitetet për monitorimin e zbatimit të veprimeve që ndërmerren për përafrimin e legjislacionit dhe imponimin e ligjeve.

NENI 71

Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike

1. Dispozitat në vijim nuk përputhen me funksionimin e duhur të Marrëveshjes, duke qenë se mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë:

- (i) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikatat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve të cilat kanë si objektiv të tyre ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës;

- (ii) abuzimi me pozicionin dominues, nga një ose më shumë sipërmarrje, në territoret e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre;
- (iii) çdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara.

2. Praktikrat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.

3. Palët sigurojnë që një institucioni publik dhe funksionalisht të pavarur t'i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (i) dhe (ii) të këtij Neni, lidhur me sipërmarrjet private dhe publike dhe sipërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta.

4. Shqipëria do të ngrejë një autoritet funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (iii) të këtij neni brenda katër vjetësh, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Ky autoritet do të ketë veç të tjerash, kompetenca për të autorizuar skema të ndihmës shtetërore dhe grante ndihme individuale në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni, si dhe kompetenca për të urdhëruar rikthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme.

5. Secila prej Palëve garanton transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, duke i paraqitur, veç të tjerash Palës tjetër një raport të rregullt vjetor, ose i njëjtë me të, duke ndjekur metodologjinë dhe paraqitjen e sondazhit të Komunitet për ndihmën shtetërore. Me kërkesë të njëjës Palë, Pala tjetër do t'i japë informacione për çështje të veçanta të ndihmës publike.

6. Shqipëria harton një inventar gjithëpërfshirës të skemave të ndihmës të krijuara para ngritjes së autoritetit të përmendur në paragrafin 4, dhe i drejton këto skema ndihme në përputhje me kriteret e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, brenda një periudhe jo më shumë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

7. Me qëllim zbatimin e dispozitave të paragrafit 1 (iii), Palët pranojnë që gjatë dhjetë viteve të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo ndihmë publike e dhënë nga Shqipëria vlerësohet duke marrë parasysh faktin se ajo konsiderohet si një zonë e njëjtë me zonat e përshkruara në Nenin 87 (3)(a) të Traktatit themelues të Komunitetit Europian.

Brenda pesë viteve që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit të Komuniteteve Europiane shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar me nivelin NUTS II. Më pas, autoriteti i përmendur në paragrafin 4 dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane vlerëson bashkërisht kriteret për pranueshmërinë e zonave të Shqipërisë si dhe intensitetin maksimal të ndihmës në lidhje me to, në mënyrë që të hartohet harta rajonale e ndihmave në bazë të direktivave përkatëse të Komunitetit.

8. Në lidhje me prodhimet e përmendura në Kapitullin II të Titullit IV:

- paragrafi 1 (iii) nuk zbatohet;
- çdo praktikë në kundërshtim me paragrafin 1(i) vlerësohet sipas kriterëve të vendosura nga Komuniteti në bazë të Neneve 36 dhe 37 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve specifike të Komunitetit të miratuara mbi këtë bazë.

9. Në qoftë se një nga Palët është e mendimit se një praktikë e veçantë nuk përputhet me termat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, ajo mund të marrë masat e nevojshme pas konsultimeve të bëra me Këshillin e Stabilizim-Asociimit ose tridhjetë ditë pune pas kërkesës për konsultim. Asgjë në këtë nen nuk cënon ose ndikon në ndonjë mënyrë për marrjen, nga secila prej Palëve, të masave antidumping ose të masave kundëvepruese në përputhje me nenet përkatëse të GATT 1994 dhe Marrëveshjes së OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese apo legjislacionit të brendshëm përkatës.

NENI 72

Sipërmarrjet publike

Brenda vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria zbaton, për sipërmarrjet publike dhe sipërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta dhe ekskluzive, parimet e parashikuara në Traktatin themelues të Komunitetit Europian, duke iu referuar veçanërisht nenit 86.

Të drejtat e veçanta të sipërmarrjeve publike gjatë periudhës tranzitore nuk përfshijnë mundësinë e vendosjes së kufizimeve sasiore, ose masave me efekt të njëjtë, mbi importet nga Komuniteti në Shqipëri.

NENI 73

Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare

1. Në përputhje me dispozitat e këtij Neni dhe Shtojcën V, Palët konfirmojnë rëndësinë që i japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si edhe imponimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.
2. Shqipëria merr masat e nevojshme për të garantuar brenda katër viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje një nivel mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të njëjtë me atë që ekziston në Komunitet, përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.
3. Shqipëria merr përsipër të bëhet palë brenda periudhës së përcaktuar më lart në konventat shumëpalëshe për të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të përmendura në Shtojcën VI, paragrafi 1. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të vendosë për të detyruar Shqipërinë të bëhet palë në Konventa të veçanta shumëpalëshe në këtë fushë.
4. Nëse ndodhin probleme në fushën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare që ndikojnë në kushtet e tregtisë, me kërkesë të një Pale, problemet i dërgohen urgjentisht Këshillit të Stabilizim-Asociimit, me synim arritjen e zgjidhjeve të kënaqshme për palët.

NENI 74

Kontratat publike

1. Palët konsiderojnë si një objektiv të dëshirueshëm liberalizimin e kontratave publike në bazë të parimit të mos-diskriminimit dhe reciprocitetit, veçanërisht në kontekstin e OBT-së.
2. Kompanive shqiptare, edhe nëse nuk janë vendosur në Komunitet, u jepet e drejta për të marrë pjesë për akordim kontrate në Komunitet sipas rregullave të prokurimit të Komunitetit, duke mos marrë trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë kompanive komunitare, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Dispozitat e mësipërme zbatohen gjithashtu në kontratat e shërbimeve publike, sapo qeveria shqiptare të ketë miratuar legjislacionin duke vendosur rregullat komunitare për këtë fushë. Komuniteti shqyrton periodikisht nëse Shqipëria ka miratuar vërtetë këtë legjislacion.
3. Kompanitë komunitare që nuk janë vendosur në Shqipëri gëzojnë të drejtën e fitimit të kontratës në Shqipëri në bazë të Ligjit shqiptar për Prokurimin Publik duke mos marrë një trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë shoqërive shqiptare, jo më vonë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.
4. Këshilli i Stabilizim-Asociimit shqyrton periodikisht mundësinë që Shqipëria të nisë lejimin për të marrë pjesë në procedurat e fitimit të kontratës në Shqipëri të gjitha kompanive komunitare.

Shoqëritë komunitare të vendosura në Shqipëri sipas dispozitave të Kapitullit II të Titullit V, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, gëzojnë të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e fitimit të kontratës duke mos marrë trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë kompanive shqiptare.

5. Në lidhje me ndërmarrjet, veprimtaritë, dhënien e shërbimeve ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë, si dhe punësimin dhe lëvizjen e punonjësve me qëllim përmbushjen e kontratave publike, aplikohen dispozitat e neneve 46 deri në 69.

NENI 75

Standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë

1. Shqipëria merr masat e nevojshme për siguruar gradualisht përputhshmërinë me rregulloret teknike të Komunitetit dhe procedurave europiane të vlerësimit të standardizimit, metrologjisë, akreditimit dhe përputhshmërisë.

2. Për këtë qëllim, Palët do të fillojnë në një fazë të hershme:

- nxitjen e përdorimit të rregulloreve teknike të Komunitetit, standardeve europiane dhe procedurave të vlerësimit të përputhshmërisë,
- dhënien e asistencës për të nxitur zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë: standardizimin, metrologjinë, akreditimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë;

- nxitjen e pjesëmarrjes së Shqipërisë në veprimtarinë e organizatave që kanë të bëjnë me standardet, vlerësimin e përputhshmërisë, metrologjinë dhe funksione të ngjashme (p.sh. CEN, CENELEC, ETSI, EA, WELMEC, EUROMET etj).
- përfundimin e Protokolleve Europiane të Vlerësimit të Përputhshmërisë, aty ku shihet e arsyeshme, menjëherë pasi kuadri ligjor dhe procedurat shqiptare të jenë përafruar „në masë të mjaftueshme me ato komunitare dhe të ekzistojë ekspertiza e përshtatshme.

NENI 76

Mbrojtja e konsumatorit

Palët do të bashkëpunojnë për përafrimin e standardeve për mbrojtjen e konsumatorëve në Shqipëri me standardet komunitare. Mbrojtja e efektshme e konsumatorit është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të ekonomisë së tregut, mbrojtje e cila varet nga zhvillimi i një infrastrukture administrative për të siguruar mbikëqyrjen e tregut dhe zbatimin e ligjeve në këtë fushë.

Për këtë qëllim, dhe në kuadër të interesave të tyre të përbashkëta, Palët do të inkurajojnë dhe garantojnë:

- një politikë për mbrojtjen aktive të konsumatorëve, në përputhje me të drejtën komunitare;
- harmonizimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve në Shqipëri me atë ekzistues në Komunitet;
- mbrojtje efektive ligjore për konsumatorët në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mallrave të konsumit, dhe ruajtjen e standardeve të duhura të sigurisë;
- monitorimin e rregullave nga autoritetet kompetente dhe garantimin e aksesit tek drejtësia në rast mosmarrëveshjes.

NENI 77

Kushtet e punës dhe mundësitë të barabarta

Shqipëria do të harmonizojë në mënyrë progresive legjislacionin e saj me atë të Komunitetit në fushën e kushteve të punës, veçanërisht të shëndetit dhe sigurisë në punë, dhe mundësive të barabarta.

TITULLI VII

LIRIA, DREJTESIA DHE SIGURIA

–

– HYRJE

NENI 78

Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës

Në bashkëpunimin e tyre në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme Palët i kushtojnë rëndësi të veçantë forcimit të shtetit të së drejtës, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si edhe imponimit të ligjeve e administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi synon veçanërisht në fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe në përmirësimin e efikasitetit të tij, në përmirësimin e funksionimit të policisë dhe organeve të tjera të imponimit të ligjeve duke siguruar trajnime të mjaftueshme dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

NENI 79

Mbrojtja e të dhënave personale

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do të harmonizojë legjislacionin për të dhënat personale me të drejtën komunitare, dhe me legjislacionin tjetër europian dhe ndërkombëtar mbi privatësinë. Shqipëria krijon organe mbikëqyrës të pavarur me burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të monitoruar dhe garantuar në mënyrë efikase imponimin e legjislacionit të brendshëm për mbrojtjen e të dhënave personale. Palët do të bashkëpunojnë për të arritur këtë qëllim.

– BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E LËVIZJES SË PERSONAVE

NENI 80

Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e vizave, kontrollit të kufijve, azilit dhe migracionit dhe të ngrenë një kuadër bashkëpunimi përshirë atë në nivel rajonal, në këto fusha, duke marrë parasysh dhe duke përdorur plotësisht nismat e tjera ekzistuese në këtë fushë siç mund të jetë e përshtatshme.

Bashkëpunimi në çështjet të sipërpërmendura bazohet në konsultimet e ndërsjella dhe bashkërendimin e ngushtë ndërmjet Palëve dhe duhet të përfshijë asistencë teknike dhe administrative për:

- shkëmbimin e informacionit mbi legjislacionin dhe praktikën;
- hartimin e legjislacionit;
- rritjen e efikasitetit të institucioneve;
- trajnimin e personelit;
- sigurinë e dokumenteve të udhëtimit dhe zbulimin e dokumenteve false;
- menaxhimin e kufijve.

Bashkëpunimi përqendrohet veçanërisht:

- në fushën e azilit për zbatimin e legjislacionit të brendshëm për përmbushjen e standardeve të Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Protokollit të Nju Jorkut të vitit 1967 për të siguruar në këtë mënyrë respektimin e parimit të mos-kthimit të individit në atë vend që përbën kërcënim për jetën e tij, si dhe të të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve;
- në fushën e migracionit të ligjshëm, për rregullat e pranimin dhe të drejtat dhe statusin e personave të pranuar. Lidhur me migracionin Palët bien dakord për një trajtim të drejtë të shtetasve të vendeve të tjera të cilët janë rezidentë të ligjshëm në territoret e tyre dhe për të promovuar politikën e integrimi që synojnë të bëjnë të drejtat dhe detyrimet e tyre të krahasueshme me ato të shtetasve të vetë.

NENI 81

Parandalimi dhe kontrolli i imigrimit të paligjshëm; ripranimi

1. Palët bashkëpunojnë për të parandaluar dhe frenuar imigrimin e paligjshëm. Për këtë qëllim, Palët, sipas kërkesës dhe pa formalitete të mëtejshme, bien dakord që Shqipëria dhe Shtetet Anëtare:

- do të ripranojnë çdo shtetas të tyre që qëndron në mënyrë të paligjshme në territoret e tyre;
- do të ripranojnë çdo shtetas të vendeve të treta dhe çdo person pa shtetësi që qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e tyre dhe që ka hyrë në territorin e Shqipërisë nëpërmjet një Shteti Anëtar, ose prej tij , apo që ka hyrë në territorin e një Shteti Anëtar nëpërmjet Shqipërisë, ose prej saj..

2. Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian dhe Shqipëria pajisin shtetasit e tyre me dokumente të përshtatshëm identifikimi dhe do t'u sigurojnë atyre lehtësirat administrative për këtë qëllim.

3. Procedura të veçanta për qëllimet e ripranimit të shtetasve, shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi janë përcaktuar në kuadrin e Marrëveshjes ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë mbi ripranimin e personave rezidentë pa autorizim, të nënshkruar më 14 prill 2005.

1. 4. Shqipëria pranon të përfundojë marrëveshjet për ripranim me vendet e procesit të Stabilizim-Asociimit dhe merr përsipër të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin fleksibël dhe të shpejtë të të gjitha marrëveshjeve të ripranimit referuara në këtë nen.

5. Këshilli i Stabilizim-Asociimit ndërmerr përpjekje të tjera të përbashkëta që mund të bëhen për të parandaluar dhe frenuar imigracionin e paligjshëm, duke përfshirë rrjetet e trafikimit dhe të migrimit të paligjshëm.

—

- BASHKËPUNIMI NË LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE, FINANCIMIT TË TERRORIZMIT,
DROGAVE TË PALIGJSHME DHE BASHKËPUNIMI PËR KUNDËRTERRORIZMIN

NENI 82

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit

1. Palët bashkëpunojnë ngushtësisht me qëllim parandalimin e përdorimit të sistemeve të tyre financiare për pastrimin e parave nga veprimtaritë kriminale në përgjithësi dhe veprat penale të drogës në veçanti, si edhe për financimin e terrorizmit.
2. Bashkëpunimi në këtë fushë mund të përfshijë asistencë teknike dhe administrative me qëllim që të zhvillohet zbatimi i akteve normative, dhe funksionimi efikas i standardeve të përshtatshme dhe mekanizmave për luftën kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit të njëjtë me ato që përdoren nga Komuniteti e forumet ndërkombëtare në këtë fushë, veçanërisht Grupi i Përbashkët për Veprimin Financiar .

NENI 83

Bashkëpunimi kundër drogave të paligjshme

1. Brenda mundësive dhe kompetencave të tyre, Palët bashkëpunojnë për të siguruar një qëndrim të balancuar dhe të integruar në drejtim të problemeve të drogës. Politikat dhe veprimet në lidhje me drogën do të përdoren për pakësimin e trafikimit, kërkesës për droga të paligjshme e furnizimit me to, si dhe për të ushtruar një kontroll më të efektshëm pas njoftimeve paralajmëruese.
2. Palët bien dakord mbi metodat e nevojshme të bashkëpunimit për arritjen e këtyre objektivave. Veprimet bazohen në parime përgjithësisht të pranuar, në përputhje me Strategjinë e BE-së për Drogën.

– BASHKËPUNIMI KUNDER TERRORIZMIT

NENI 84

Palët bien dakord të bashkëpunojnë për të parandaluar dhe eliminuar aktet terroriste dhe financimet e tyre, veçanërisht ato që përfshijnë veprimtaritë ndërkufitare, që janë në përputhje me konventat ndërkombëtare ku ato bëjnë pjesë, si dhe me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse.:

- në kuadër të zbatimit të plotë të Rezolutës 1373 të Këshillit të Sigurimit dhe rezolutave të tjera përkatëse të OKB-së, instrumenteve dhe konventave ndërkombëtare;
- nëpërmjet shkëmbimit të informacionit për grupet terroriste dhe rrjeteve të tyre mbështetëse, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe atë të brendshme;

– nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës në lidhje me mjetet dhe metodat për të luftuar terrorizmin si dhe në fushën teknike dhe të trajnimit, dhe përmes shkëmbimit të eksperiencës për parandalimin e terrorizmit.

–

– BASHKEPUNIMI NË ÇËSHTJET PENALE

NENI 85

Parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme

Palët bashkëpunojnë në luftën dhe parandalimin e veprimtarive kriminale dhe të paligjshme, të organizuara ose jo, të tilla si:

- kontrabanda dhe trafikimi i qenieve njerëzore;
- aktivitete ekonomike të paligjshme, dhe në veçanti falsifikimi i monedhave, transaksionet e paligjshme me prodhime të tilla si mbetje industriale, materiale radioaktive dhe transaksione që kanë lidhje me prodhime të paligjshme ose të falsifikuara;
- korrupsioni, si në sektorin privat ashtu dhe në atë publik, veçanërisht kur ka të bëjë me praktika administrative jo-transparente;
- mashtrimi fiskal;
- trafikimi i paligjshëm i drogave dhe lëndëve psikotrope;
- kontrabanda;
- trafikimi i paligjshëm i armëve;

- falsifikimi i dokumenteve;
- trafikimi i paligjshëm i makinave;
- krimi kibernetik

Do të nxitet bashkëpunimi rajonal dhe respektimi i standardeve të njohura ndërkombëtare në luftën kundër krimit të organizuar.

TITULLI VIII POLITIKAT E BASHKËPUNIMIT

NENI 86

1. Komuniteti dhe Shqipëria do të vendosin një bashkëpunim të ngushtë për të kontribuar në potencialin e zhvillimit dhe rritjes së Shqipërisë. Një bashkëpunim i tillë do të forcojë lidhjet ekonomike ekzistuese në një bazë sa më të gjerë, për përfitimin e të dyja palëve.
2. Do të hartohen politika dhe masa të tjera të hartuara për të sjellë zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm në Shqipëri. Këto politika duhet të sigurojnë që çështjet e mjedisit të jenë të përfshira që nga fillimi dhe të lidhura me kërkesat për zhvillimin e harmonizuar social.

3. Politikat e bashkëpunimit do të integrohen në një kuadër rajonal bashkëpunimi. Kujdes i veçantë duhet t'u kushtohet masave që mund të nxisin bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve fqinje të saj duke përfshirë Shtetet Anëtare, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të përcaktojë përparësitë ndërmjet dhe brenda politikave të bashkëpunimit të përshkruara në vijim.

NENI 87

Politikat ekonomike dhe tregtare

1. Komuniteti dhe Shqipëria do të lehtësojnë procesin e reformave ekonomike nëpërmjet bashkëpunimit për të përmirësuar mirëkuptimin e bazave të ekonomive të tyre përkatëse, si dhe formulimin dhe zbatimin e politikave ekonomike në ekonominë e tregut.
2. Me kërkesë të autoriteteve Shqiptare, Komuniteti mund të japë asistencë që synon mbështetjen e përpjekjeve të Shqipërisë për ndërtimin e një ekonomie funksionale tregu, si dhe për të përafuar gradualisht politikat e saj me politikat stabilizuese të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.
3. Bashkëpunimi ka si synim gjithashtu forcimin e shtetit të së drejtës në fushën e biznesit nëpërmjet një kuadri ligjor tregtar ,jo-diskriminues dhe të qëndrueshëm.
4. Bashkëpunimi në këtë fushë përfshin shkëmbim joformal të informacionit në lidhje me parimet dhe funksionimin e Bashkimit European Ekonomik dhe Monetar.

NENI 88

Bashkëpunimi statistikor

Bashkëpunimi midis Palëve përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e statistikave. Ai synon veçanërisht zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna të krahasueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformës në Shqipëri. Ky sistem duhet gjithashtu të mundësojë Institutin Shqiptar të Statistikës për të përmbushur më mirë nevojat e klientëve vendas dhe ndërkombëtarë (si të administratës publike ashtu dhe sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të nxjerra nga OKB-ja dhe Kodi Statistikor European i Praktikës dhe parashikimet e se drejtës Statistike Europiane, dhe duhet të zhvillohet drejt *acquis* e Komunitetit.

NENI 89

Veprimtaritë bankare, sigurimet dhe shërbime të tjera financiare

Bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit do të përqendrohet në fusha prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushat e veprimeve bankare, sigurimeve dhe shërbimeve financiare. Palët bashkëpunojnë me qëllim ngritjen dhe zhvillimin e një kuadri të përshtatshëm për nxitjen e sektorëve të shërbimeve bankare, sigurimeve dhe atyre financiare në Shqipëri.

NENI 90

Bashkëpunimi për auditimin dhe kontrollin financiar

Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushat e kontrollit financiar të brendshëm publik (KFBP) dhe auditimit të jashtëm. Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas të KFBP (Kontrolli i Financiar i Brendshëm Publik)dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuar botërisht si edhe me praktikatat më të mira të BE-së.

NENI 91

Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

Bashkëpunimi mes Palëve, në kuadër të përmbushjes së kompetencave përkatëse në fushën e nxitjes dhe mbrojtjes së investimeve, ka si synim krijimin e një klime të favorshme për investimet private, vendase dhe të huaja, e cila është thelbësore për rimëkëmbjen ekonomike dhe industriale të Shqipërisë.

NENI 92

Bashkëpunimi industrial

Bashkëpunimi ka si synim të nxisë modernizimin dhe ristrukturimin e industrisë shqiptare dhe sektorëve të veçantë, ashtu si edhe bashkëpunimin industrial midis operatorëve ekonomikë, me synim forcimin e sektorit privat në kushte të cilat sigurojnë mbrojtjen e mjedisit.

Iniciativat e bashkëpunimit industrial do të reflektojnë përparësitë e përcaktuara nga të dy Palët. Ata do të marrin në konsideratë aspektet rajonale të zhvillimit industrial, duke nxitur partneritetet ndërkombëtare kur është e përshtatshme. Iniciativat duhet të synojnë në mënyrë të veçantë ngritjen e një kuadri të përshtatshëm për sipërmarrjet, përmirësimin e menaxhimit dhe ekspertizës, dhe promovimin e tregjeve, transparencës së tregut dhe mjedisit të biznesit.

Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë *acquis* e Komunitetit në fushën e politikave industriale.

NENI 93

Ndërmarrjet e vogla e të mesme

Bashkëpunimi mes Palëve synon forcimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme (SME-ve) të sektorit privat dhe merr parasysh fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e SME-ve, si edhe parimet e përfshira në Kartën Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla.

NENI 94

Turizmi

Bashkëpunimi mes Palëve në fushën e turizmit kryesisht do të synojë përmirësimin e përcjelljes së informacionit mbi turizmin (nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare, bazave të të dhënave) dhe transferimin e ekspertizës (nëpërmjet trajnimeve, shkëmbimeve, seminareve). Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë pjesën e duhur nga *acquis* e Komunitetit që lidhet me këtë sektor.

Bashkëpunimi mund të integrohet në një kuadër rajonal bashkëpunimi.

NENI 95

Bujqësia dhe sektori agro-industrial

Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në sferat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e bujqësisë. Bashkëpunimi do të ketë si synim veçanërisht modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet komunitare.

NENI 96

Peshkimi

Palët do të shqyrtojnë mundësinë e identifikimit të fushave me përfitim të ndërsjellë dhe interes të përbashkët në sektorin e peshkimit. Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e peshkimit, duke përfshirë respektimin e detyrimeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me rregullat e menaxhimit të Organizatës Ndërkombëtare dhe Rajonale të Peshkimit dhe ruajtjen e burimeve të peshkimit.

NENI 97

Doganat

1. Palët do të vendosin një bashkëpunim në këtë fushë me synim garantimin e përputhjes me dispozitat që do të miratohen në fushën e tregtisë, dhe për të arritur përafrimin e sistemit doganor shqiptar me atë të Komunitetit, duke ndihmuar kështu në hapjen e rrugës për marrjen e masave liberalizuese të planifikuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar për doganat me atë të *acquis*.
2. Bashkëpunimi do të marrë parasysh në mënyrën e duhur fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushat e doganave.
3. Protokollin 6 vendos rregullat e asistencës të ndërsjellë administrative mes Palëve në fushën e doganave.

NENI 98

Tatimet

- 1. Palët vendosin bashkëpunim në fushën e tatimeve duke përfshirë masat që synojnë forcimin e reformave të mëtejshme në sistemin fiskal dhe në ristrukturimin e administratës së tatimeve me synimin që të sigurohet efikasitet në mbledhjen e taksave dhe në luftën kundër evazionit fiskal.

- 2. Bashkëpunimi do të marrë parasysh në mënyrën e duhur fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e tatimeve dhe të luftës kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Në këtë aspekt, Palët njohin rëndësinë e përmirësimit të transparencës dhe shkëmbimit të të dhënave ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, në mënyrë që të lehtësohet imponimi i masave që parandalojnë mospagimin ose evazionin e taksave. Për më tepër, Palët konsultohen me njëra-tjetrën, qysh nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, me synim që të eliminohet konkurrenca e dëmshme e tatimeve ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë me qëllim që të sigurohet një trajtim i barabartë në fushën e tatimit të biznesit.

NENI 99

Bashkëpunimi social

Palët bashkëpunojnë për të lehtësuar reformat e politikave shqiptare të punësimit, në kontekstin e forcimit të reformave ekonomike dhe të integritit. Bashkëpunimi synon të mbështesë përshtatjen e sistemit shqiptar të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike dhe sociale, dhe përfshin përshtatjen e legjislacionit shqiptar për sa u përket kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për gratë, ashtu si dhe përmirësimin e nivelit të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë për punëtorët, duke ju referuar nivelit ekzistues të mbrojtjes në Komunitet.

Bashkëpunimi merr parasysh fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në këtë fushë.

NENI 100

Arsimi dhe trajnimi

1. Palët bashkëpunojnë me synim ngritjen e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe trajnimit profesional në Shqipëri, ashtu si edhe të politikave për rininë dhe punës me rininë. Një nga përparësitë për sistemin e arsimit të lartë është arritja e objektivave të Deklaratës së Bolonjës.

2. Palët bashkëpunojnë gjithashtu për të garantuar që aksesimi në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Shqipëri të mos i nënshtrohet diskriminimit në bazë të gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë.
3. Programet dhe instrumentet përkatës të Komunitetit do të kontribuojnë për rritjen e nivelit të strukturave dhe veprimtarive arsimore dhe trajnuese në Shqipëri.
4. Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në këtë fushë.

NENI 101

Bashkëpunimi kulturor

Palët marrin përsipër të nxisin bashkëpunimin kulturor. Ky bashkëpunim shërben, vec të tjerash për të rritur mirëkuptimin e ndërsjellët dhe vlerësimin midis individëve, komuniteteve dhe popujve. Palët marrin gjithashtu përsipër të nxisin shumëllojshmërinë kulturore, veçanërisht në kuadrin e Konventës së UNESCO-s për mbrojtjen dhe nxitjen e larmisë të shprehjeve kulturore.

NENI 102

Bashkëpunimi në fushën audio-vizuale

1. Palët bashkëpunojnë për të zhvilluar industrinë audio-vizive në Evropë, dhe për të përkrahur bashkëprodhimin në fushat e kinemasë dhe televizionit.
2. Bashkëpunimi mund të përfshijë, vec të tjerash programet dhe lehtësirat për trajnimin e gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias, ashtu si edhe asistencën teknike ndaj medias publike dhe private, me qëllim përforcimin e pavarësisë së tyre, profesionalizmin dhe lidhjeve me median evropiane.
3. Shqipëria do t'i përafrojë politikat e saj mbi rregullimin e aspekteve të përmbajtjes së transmetimeve ndërkufitare me ato të KE-së, dhe do të harmonizojë legjislacionin e saj me *acquis* e BE-së. Shqipëria do t'i kushtojë kujdes të veçantë përvetësimit të së drejtës së pronësisë intelektuale për programet dhe transmetimin me satelit, frekuenca tokësore dhe kablllo.

NENI 103

Shoqëria e informacionit

1. Bashkëpunimi do të përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komuniteteve për shoqërinë e informacionit. Ai do të mbështesë kryesisht orientimin gradual të politikave dhe legjislacionit të Shqipërisë për këtë sektor me ato të Komunitetit.

2. Palët do të bashkëpunojnë gjithashtu për të zhvilluar më tej Shoqërinë e Informacionit në Shqipëri. Objektivat globale do të përgatisin shoqërinë në tërësi për epokën dixhitale, duke tërhequr investimet dhe duke siguruar aftësinë e rrjeteve dhe shërbimeve për përdorimin e informacionit.

NENI 104

Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik

Bashkëpunimi do të përqendrohet së pari në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në këtë fushë.

Palët do të forcojnë, në veçanti bashkëpunimin në fushat e rrjeteve të komunikimit elektronik e shërbimeve të lidhura me to, me objektivin përfundimtar të miratimit nga Shqipëria të *acquis* të Komunitetit në këto sektorë një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 105

Informacioni dhe komunikimi

Komuniteti dhe Shqipëria do të marrin masat e nevojshme për të nxitur shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit. Përparësi do u jepet programeve që synojnë dhënien e informacionit bazë lidhur me Komunitetin për publikun e gjerë dhe dhënies së informacioneve më të specializuara për rrethet profesionale në Shqipëri.

NENI 106

Transporti

Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e transportit.

Bashkëpunimi mund të synojë, veçanërisht në ristrukturimin dhe modernizimin e metodave shqiptare të transportit, duke përmirësuar lëvizjen e lirë të pasagjerëve dhe mallrave, duke zgjeruar mundësinë për në tregun dhe mjetet e transporteve, duke përfshirë portet dhe aeroportet, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturave multi-modale në lidhje me rrjetet kryesore Trans-Evropiane, në veçanti për të forcuar dukshëm lidhjet rajonale, duke arritur standardet operative të krahasueshme me ato të Komunitetit, duke zhvilluar një sistem transporti në Shqipëri në pajtim dhe të përafëruar me atë të Komunitetit, si edhe duke përmirësuar mbrojtjen e mjedisit të transportit.

NENI 107

Energjia

Bashkëpunimi do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e energjisë, duke përfshirë, sipas rastit, aspektet e sigurisë bërthamore. Ky bashkëpunim do të pasqyrojë parimet e ekonomisë së tregut dhe bazohet në Traktatin ,të nënshkruar, rajonal të Komunitetit për Energjinë me synim integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet Evropiane të energjisë.

NENI 108

Mjedisi

Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit për fushën e mjedisit.

NENI 109

Bashkëpunimi në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik

1. Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin në kërkimet civile shkencore dhe zhvillimin teknologjik mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë dhe duke marrë parasysh burimet e disponueshme, aksesin e duhur në programet e tyre përkatëse, të kushtëzuara këto nga nivelet e përshtatshme të mbrojtjes efikase të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare .
2. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik.
3. Bashkëpunimi do të zbatohet në bazë të marrëveshjeve specifike që do të negociohen dhe përfundohen në bazë të procedurave të miratuara nga secila Palë.

NENI 110

Zhvillimi rajonal dhe lokal

1. Palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkufitar, transkombëtar dhe interrajonat.
2. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e zhvillimit rajonal.

NENI 111

Administrata publike

- 1. Bashkëpunimi do të synojë mundësimin e zhvillimit të një administrate publike eficiente dhe të përgjegjshme në Shqipëri, e cila mbështet në veçanti vënien në zbatim të shtetit të së drejtës funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore për të mirën e popullsisë shqiptare në tërësi dhe të zhvillimit normal të marrëdhënieve mes BE-së dhe Shqipërisë.
-
- 2. Bashkëpunimi në këtë fushë do të përqendrohet kryesisht në ndërtimin e institucioneve, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave transparente dhe të paanshme të rekrutimit, menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm dhe promovimin e etikës në administratën publike dhe qeverisjes elektronike. Bashkëpunimi përfshin si administratën qendrore, ashtu dhe atë vendore.

TITULLI IX

BASHKEPUNIMI FINANCIAR

NENI 112

Për të arritur objektivat e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me nenet 3, 113 dhe 115, Shqipëria mund të marrë asistencë financiare nga Komuniteti në formë granti dhe huaje, duke përfshirë hua nga Banka Evropiane e Investimeve. Ndihma Komunitare varet nga përmbushja e parimeve dhe kushteve të parashikuara në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme më 29 prill 1997, duke marrë parasysh rezultatet e raporteve vjetore të vendeve në Procesin e Stabilizim Asociimit, Partneriteteve Europiane, dhe të konkluzioneve të tjera të Këshillit, të cilat i përkasin në mënyrë të veçantë respektimit të programeve rregulluese. Ndihma që i jepet Shqipërisë do të orientohet drejt nevojave të konstatuara, përparësive të zgjedhura dhe kapacitetit për të thithur dhe për të dhënë rezultate, si edhe masave të marra për reformimin dhe ristrukturimin e ekonomisë.

NENI 113

Asistenca financiare, në formën e granteve, duhet të trajtohet nga masat operationale të parashikuara në Rregulloren përkatëse të Këshillit brenda kuadrit të treguesve shumë vjeçarë të caktuar nga Komuniteti pas konsultimeve me Shqipërinë.

Asistenca financiare mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, përafrimit të legjislacionit dhe zhvillimit ekonomik.

NENI 114

Me kërkesë të Palës shqiptare dhe në rastet e nevojës së veçantë, Komuniteti, duke u koordinuar me institucionet ndërkombëtare financiare, mund të shqyrtojë mundësinë, duke bërë përjashtim,, e dhënies së asistencës makro-financiare, e cila varet nga kushte të caktuara dhe duke marrë parasysh disponimin e të gjitha burimeve financiare. Kjo asistencë mund të jepet vetëm kur përmbushen kushtet që do të vendosin në kontekstin e një programi për të cilin është rënë dakord mes Shqipërisë dhe FMN-së.

NENI 115

Me qëllim që të realizohet përdorimi sa më optimal të burimeve ekzistuese, Palët garantojnë që kontributet e Komunitetit të bëhen në bashkëpunim të ngushtë me ato kontribute të ardhura nga burime të tjera si prej Shteteve Anëtare, vendeve të tjera dhe institucioneve financiare ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, informacioni për çdo burim të asistencës shkëmbehet rregullisht ndërmjet Palëve.

TITULLI X
DISPOZITAT INSTITUCIONALE, TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

NENI 116

Me anë të kësaj Marrëveshjeje krijohet një Këshill i Stabilizim Asociimit, i cili mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e Marrëveshjes. Këshilli mblidhet në një nivel të përshtatshëm në intervale të rregullta kohe dhe kur ta kërkojnë rrethanat. Ai shqyrton çështjet më të rëndësishme që dalin në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe ato çështje dypalëshe ose ndërkombëtare me interes të përbashkët.

NENI 117

1. Këshilli i Stabilizim Asociimit përbëhet nga anëtarë të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anëtarë të Komisionit të Komuniteteve Evropiane, nga njëra anë, dhe anëtarë të Qeverisë së Shqipërisë, nga ana tjetër.
2. Këshilli i Stabilizim Asociimit vendos rregulloren e brendshme të tij.
3. Anëtarët e Këshillit të Stabilizim Asociimit mund të përfaqësohen, në përputhje me kushtet e parashikuara në rregulloren e brendshme.
4. Këshilli i Stabilizim Asociimit kryesohet me rotacion nga një përfaqësues i Komunitetit Evropian dhe një përfaqësues i Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në rregulloren e brendshme.

5. Banka Evropiane e Investimeve merr pjesë, si vëzhguese gjatë punimeve të Këshillit të Stabilizim Asociimit, për çështjet që lidhen me të.

NENI 118

Këshilli i Stabilizim Asociimit, me qëllim arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje, ka kompetencën për të marrë vendime brenda objektivit të Marrëveshjes, për çështjet e parashikuara në të. Vendimet e marra janë detyruese për Palët, të cilat do të marrin masat e nevojshme për t'i zbatuar vendimet e marra. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund të bëjë rekomandimet përkatëse. Ai harton vendimet dhe rekomandimet e tij me marrëveshje mes Palëve.

NENI 119

Palët do t'i paraqesin Këshillit të Stabilizim Asociimit çdo mosmarrëveshje që lidhet me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund ta zgjidhë mosmarrëveshjen nëpërmjet një vendimi detyrues.

NENI 120

1. Këshilli i Stabilizim Asociimit asistohet gjatë zbatimit të detyrave të tij nga Komiteti i Stabilizim Asociimit, i përbërë nga përfaqësues të Këshillit të Bashkimit European e përfaqësues të Komisionit të Komunitetit Evropian, nga njëra anë, dhe përfaqësues të Shqipërisë, nga ana tjetër.
2. Në rregulloren e tij të brendshme, Këshilli i Stabilizim Asociimit vendos detyrat e Komitetit të Stabilizim Asociimit, të cilat përfshijnë përgatitjen e takimeve të Këshillit të Stabilizim Asociimit, dhe vendos për mënyrën e funksionimit të Komitetit
3. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund t'i delegojë Komitetit të Stabilizim Asociimit cilëndo kompetencë të tij. Në këtë rast Komiteti i Stabilizim Asociimit merr vendimet e tij duke ju përmbajtur kushteve të parashikuara në nenin 117.
4. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund të vendosë të ngrëjë komitete ose organe të tjera të veçanta, që mund ta ndihmojë atë në kryerjen e detyrave të tij. Në rregulloren e tij të brendshme, Këshilli i Stabilizim Asociimit vendos përbërjen dhe detyrat e komiteteve apo organeve të tilla dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

NENI 121

Komiteti i Stabilizim Asociimit mund të krijojë nën-komitete.

Para përfundimit të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Komiteti i Stabilizim Asociimit do të krijojë nën-komitetet e nevojshme për zbatimin e duhur të Marrëveshjes. Gjatë vendimmarrjes për krijimin e këtyre nën komiteteve dhe përcaktimit të termave të tyre të referencës, Komiteti i Stabilizim Asociimit merr parasysh në mënyrën e duhur rëndësinë e trajtimit të çështjeve të migrimit, veçanërisht në lidhje me zbatimin e dispozitave të neneve 80 dhe 81 të kësaj Marrëveshjeje dhe monitorimin e Planit të Veprimit të BE-së për Shqipërinë dhe rajonin fqinj.

NENI 122

Vendoset krijimi i Komitetit Parlamentar për Stabilizim Asociimin. Ky Komitet është forumi i Anëtarëve të Kuvendit Shqiptar dhe Parlamentit Europian për të diskutuar dhe shkëmbyer mendimet e tyre. Ai mbledhet në intervale kohore që vendosen nga ai vetë.

Komiteti Parlamentar për Stabilizim Asociimin përbëhet nga anëtarë të Parlamentit Evropian, nga njëra anë, dhe anëtarë të Kuvendit shqiptar, nga ana tjetër.

Komiteti Parlamentar për Stabilizim Asociimin e vendos vetë rregulloren e brendshme.

Komiteti Parlamentar për Stabilizim Asociimin kryesohet me rotacion nga Parlamenti Europian dhe Parlamenti Shqiptar, sipas dispozitave që do të parashikohen nga rregullorja e brendshme.

NENI 123

Brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, çdo Palë merr përsipër t'u sigurojë personave fizikë dhe juridikë të Palës tjetër, pa i diskriminuar në krahasim me shtetasit e vet, të drejtën për të mbrojtur të drejtat individuale dhe të drejtat e tyre të pronës tek organet kompetente gjyqësore dhe administrative të secilës prej Palëve..

NENI 124

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk pengon një Palë të marrë masa:

- a) të cilat ajo i konsideron të nevojshme për të parandaluar publikimin e informacionit në kundërshtim me interesat thelbësorë të sigurisë;
- b) të cilat lidhen me prodhimin ose tregtimin e armëve, municioneve ose materialeve luftarake, ose me kërkimin shkencor, zhvillimin ose prodhimin e domosdoshëm për çështjet e mbrojtjes, me kusht që këto masa të mos dëmtojnë kushtet e konkurrencës në lidhje me prodhimet që nuk destinohen për qëllime specifike ushtarake;
- c) të cilat ajo i konsideron thelbësore për sigurinë e saj, në rastin e trazirave serioze të brendshme që çenojnë ruajtjen e rendit dhe të ligjeve, në kohë lufte ose tensioni ndërkombëtar serioz që përbën një kërcënim lufte, ose me qëllim që të përmbushë detyrimet që ka pranuar për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

NENI 125

- 1 Në fushat që mbulon kjo Marrëveshje dhe pa cënuar asnjë dispozitë të veçantë të saj:
 - Rregullimet e zbatuara nga Shqipëria në lidhje me Komunitetin nuk duhet të jenë burim diskriminimi mes Shteteve Anëtare, qytetarëve të tyre, kompanive ose firmave;
 - Rregullimet e zbatuara nga Komuniteti në lidhje me Shqipërinë nuk duhet të jenë burim diskriminimi mes qytetarëve, kompanive dhe firmave shqiptare.
- 2 Dispozitat e paragrafit 1 nuk çenojnë të drejtën e Palëve për të zbatuar dispozitat përkatëse të legjislacionit të tyre fiskal për taksapaguesit, të cilët nuk gjenden në të njëjtën situatë për sa i përket vendbanimit të tyre.

NENI 126

1. Palët do të marrin të gjitha masat specifike ose të përgjithshme që duhen për të përmbushur detyrimet e dala nga kjo Marrëveshje. Ato do të kujdesen që objektivat e parashikuara në këtë Marrëveshje të përmbushen.
2. Nëse një nga Palët mendon se Pala tjetër ka dështuar në përmbushjen e një prej detyrimeve të kësaj Marrëveshje, ajo mund të marrë masat e duhura. Para se të veprojë në këtë mënyrë, me përjashtim të rasteve tepër urgjente, ajo i paraqet Këshillit të Stabilizim Asociimit një material me informacionin përkatës për një ekzaminim të plotë të situatës, me synim kërkimin e një zgjidhjeje të pranueshme për Palët.

3. Gjatë përzgjedhjes së masave, përparësi u jepet detyrimisht atyre që çënojnë më pak funksionimin e kësaj Marrëveshje. Këto masa i bëhen të ditura menjëherë Këshillit të Stabilizim Asociimit dhe bëhen objekt konsultimesh në Këshillin e Stabilizim Asociimit, nëse këtë e kërkon Pala tjetër.

NENI 127

Palët bien dakord që të konsultohen, sa më shpejt që të jetë e mundur nëpërmjet kanaleve përkatëse, me kërkesë të njëres prej Palëve, për të diskutuar çdo çështje që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje si dhe aspekte të tjera relevante të marrëdhënieve ndërmjet Palëve.

Dispozitat e këtij neni nuk ndikojnë aspak dhe nuk çënojnë nenet 31, 37, 38, 39 dhe 43.

NENI 128

Kjo Marrëveshje nuk cënon të drejtat e siguruara nëpërmjet marrëveshjeve ekzistuese ndërmjet një ose më shumë Shteteve Anëtare, nga njëra anë, dhe Shqipërinë, nga ana tjetër, deri atëherë kur të realizohen, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, të drejta të barazvlefshme të individëve dhe operatorëve ekonomikë

NENI 129

Protokollet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 dhe Shtojca I deri në VI përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Marrëveshja Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programet e Komunitetit, të nënshkruar më 22 nëntor 2004¹, dhe Shtojca e saj janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje. Rishikimi i parashikuar në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje Kuadër kryhet nga Këshilli i Stabilizim Asociimit, që ka kompetencën të ndryshojë Marrëveshjen Kuadër nëse është e nevojshme.

NENI 130

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pakufizuar.

Secila Palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke njoftuar Palën tjetër. Kjo Marrëveshje shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së këtij njoftimi.

NENI 131

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “Palët” nënkupton Komunitetin, ose Shtetet Anëtare të tij, ose Komunitetin dhe Shtetet Anëtare, në përputhje me kompetencat përkatëse të tyre, nga njëra anë, dhe Shqipërinë, nga ana tjetër.

¹ FZ L.192, 22 korrik 2005, fq.2

NENI 132

Kjo Marrëveshje zbatohet në territoret ku zbatohen Traktatet themeluese të Komunitetit Evropian dhe të Komunitetit Evropian për Energjinë Atomike, sipas kushteve të parashikuara në këto Traktate, nga njëra anë, dhe në territorin e Shqipërisë, nga ana tjetër.

NENI 133

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian do të jetë visari i Marrëveshjes.

NENI 134

Kjo Marrëveshje hartohet në duplikatë në të gjitha gjuhët zyrtare të Palëve në tekste njëlloj autentike.

NENI 135

Palët e ratifikojnë ose miratojnë këtë Marrëveshje në bazë të procedurave të veta.

Instrumentet e ratifikimit dhe miratimit depozitohen tek Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, pas datës se depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose miratimit.

NENI 136

Marrëveshja e përkohshme

Në rastin kur në pritje të përfundimit të procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e disa pjesëve të Marrëveshjes, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me lëvizjen e lirë të mallrave ashtu dhe dispozitat përkatëse për Transportin, zbatohen në bazë të Marrëveshjeve të Përkohshme midis Komunitetit dhe Shqipërisë, Palët bien dakord, që në rrethana të tilla, për të përmbushur dispozitat e Titullit IV, nenit 40, 71, 72, 73 dhe 74 të kësaj Marrëveshjeje, Protokollet 1, 2, 3, 4 dhe 6, dhe dispozitat përkatëse të Protokollit 5 të kësaj Marrëveshjeje, fjalët “data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje” nënkuptojnë datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përkohshme në lidhje me detyrimet e parashikuara në dispozitat e sipërpërmendura.

2.

3. NENI 137

4.

5. Prej datës së hyrjes së saj në fuqi, kjo Marrëveshje do të zëvendësojë Marrëveshjen ndërmjet Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi tregtinë dhe bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik, të nënshkruar në Bruksel më 11 maj 1992. Kjo nuk do të prekë asnjë të drejtë, detyrim apo situatë ligjore të palëve, të krijuara nëpërmjet ekzekutimit të asaj Marrëveshjeje.